
	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 1 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>



KOSTT

Raport Vjetor 2017

(01.01.2017-31.12.2017)


Bordi i Drejtorët në mbledhjen e 99/18 të datës 23 shkurt 2018 njëzëri miratoi Raportin vjetor për vitin 2017.

Vendimi 180223 - II/4

Bordi i Drejtorëve njëzëri miratoi Raportin vjetor për vitin 2017.


	Përgatiti	Kontrolloi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Nebih Haziri - Zyrtar Kryesor për Financa dhe Trezor	Kadri Kadriu -U.D.Kryeshef Ekzekutiv	Bordi i Drejtorëve Kryesuesi i mbledhjes Gani Jashari
Nënshkrimi			
Data	<i>Shkurt, 2018</i>	<i>Shkurt, 2018</i>	<i>Shkurt, 2018</i>




	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 2 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Raport Vjetor për Bordin e Drejtorëve në KOSTT
Periudha Janar - Dhjetor 2017

1	Titulli i Dokumentit	Raport Vjetor 2017
2	Dërguesi i dokumentit	Kadri Kadriu, U.D. Kryeshef Ekzekutiv
3	Përmbajtja e Raportit	<p>Përmbajtja</p> <p>Fjala hyrëse e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të KOSTT</p> <p>Fjala hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT</p> <p>1. Raporti i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve</p> <p>1.1. Aktivitete kryesore të ndërmarra gjatë vitit</p> <p>1.2. Komisionet e Bordit dhe përbërja</p> <p>1.3. Të dhënat për drejtorët jo-ekzekutiv</p> <p>1.4. Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe plani i vitit aktual</p> <p>1.5. Ngjarjet të cilët kanë ndikuar në funksionimin e KOSTT-it</p> <p>1.6. Pasqyrë e të priturve për vitin e ardhshëm</p> <p>1.7. Informacionet lidhur me kapitalin dhe dividendin</p> <p>1.8. Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit</p> <p>2. Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv</p> <p>2.1. Arritjet kryesore</p> <p>2.2. Ngjarjet kryesore të vitit</p> <p>2.3. Pasqyrë e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës</p> <p>2.3.1. Balanca e planifikuar dhe e realizuar për Janar-Dhjetor 2017</p> <p>2.3.2. Indikatorët Kyç të Performancës – operimi i sistemit</p> <p>2.3.3. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i transmetimit</p> <p>2.3.4. Operimi i tregut</p> <p>2.3.5. Pasqyra e performancës financiare dhe rezultatet</p> <p>2.3.6. Analiza e IKP-ve financiare</p> <p>2.4. Progresi me planin e biznesit</p> <p>2.5. Realizimi i projekteve kryesore kapitale gjatë vitit 2017</p> <p>2.6. Perspektiva për vitin e ardhshëm</p>

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 3 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

		<p>2.7. Rreziqet</p> <p>Anekset</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Sponzorimet dhe donacionet 2. Raportet e auditorit të brendshëm 3. Raportimet sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike <p>3.1. Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet gjatë vitit 3.2. Përmbledhja dhe përshkrimi i procedurave gjyqësore 3.3. Kontratat/transaksionet e konsiderueshme gjatë vitit 2017 nga burimet e KOSTT 3.4. Sugjerime dhe propozime për rritjen e performancës</p> <p>Lista e shkurtesave</p>
4	Data e Raportimit	


	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 4 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Hyrje

Raporti Vjetor për vitin 2017 është përpiluar bazuar në dispozitën e nenit 31.3 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Sipas këtij Ligji, brenda 45 ditëve pas përfundimit të vitit kalendarik, zyrtarët e NP-së do të përgatisin një raport vjetor i cili i dorëzohet Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it për miratim.

Ky Raport është punuar sipas formës së aprovuar nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike ndërsa përmbajtja e tij është e bazuar në “Udhëzuesin për përpilimin e Raportit Vjetor të Ndërmarrjes Publike”.

Raporti paraqet rezultate kryesore të aktiviteteve të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve gjatë vitit 2017 si dhe të aktiviteteve krahasuar me Planin e Biznesit, planin vjetor dhe shkallën e realizimit, respektivisht, implementimin e Planit të Biznesit.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 5 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Fjala hyrëse e Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it

Viti 2017 është karakterizuar me një dinamikë të shtuar të aktiviteteve në përmbylljen e projekteve investive si dhe hapjen e tregut të energjisë elektrike.

Gjatë vitit 2017 janë përfunduar projektet investive të financuara nga Banka Zhvillimore Gjermane (Faza IV-V), me të cilat janë ngritur kapacitetet transmetuese dhe përbushja e kriterëve të sigurisë së operimit.

KOSTT gjithashtu ka shënuar progres të konsiderueshëm në implementimin e masave për hapjen e tregut të energjisë elektrike, sipas kërkesave të ligjeve të reja të energjisë dhe zotimeve të Qeverisë së Kosovës në kuadër të proceseve të integrimi regjionale.

Sfidë e veçantë për KOSTT edhe gjatë këtij viti ka vazhduar të jetë mos implementimi i Marrëveshjes së Kështjës KOSTT – ENTSOE, gjë që ka pamundësuar vënien në operim të linjës 400kV Kosovë-Shqipëri, si dhe ka pamundësuar përbushjen e obligimeve tjera të KOSTT.


Në kuptim të parametrave tjerë operative dhe afariste KOSTT ka pasur një performancë të shumë të mirë teknike në kuadër të normave të përcaktuara, e cila është paraprirë nga mirëmbajtja e duhur preventive, ndërsa në aspektin financiar edhe pse në fund të periudhës KOSTT është ekspozuar ndaj efekteve jashtë kontrollit të të vetë janë marrë masa për të minimizuar efektin e këtyre ndikimeve.

Bordi i Drejtorëve në përbushje të detyrave të mbikëqyrjes në vazhdimësi ka shqyrtuar aspektet operative dhe afariste të KOSTT dhe ka ofruar udhëzime dhe këshilla për menaxhmentin.

Bordi i Drejtorëve mbetet i përkushtuar që të avancojë pozitën e KOSTT në Kosovë dhe rajon në mënyrë që KOSTT të jetë në pozitë të barabartë me ndërmarrjet simotra.

Sinqerisht,

Bordi i Drejtorëve

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 6 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buscheti</i>

Fjala e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT sh.a

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj,

KOSTT në vitin 2017 me sukses ka realizuar objektivat e parashikuara me Planin e Biznesit për vitin 2017. Siguria e furnizimit dhe besueshmëria e lartë e operimit të sistemit si qëllime kryesore të KOSTT janë përmbushur me sukses. Për më shumë janë arritur rezultate të rëndësishme nëpërmjet aktiviteteve proaktive në drejtim të përmbushjes së objektivave strategjike të kompanisë dhe Planit të Biznesit.

KOSTT gjatë vitit 2017 ka pasur rolin kryesor në sektorin e energjisë në implementimin e obligimeve që derivojnë nga Ligji i Energjisë Elektrike, në formësimin e reformave të sektorit të cilat ndërlidhen me liberalizimin e tregut të energjisë në Kosovë dhe inkuadrimit në tregun regional.

Në Prill të vitit 2017 Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka nxjerrë udhëzuesin për hapjen e tregut të energjisë elektrike me shumicë me të cilin është bërë derregullimi i çmimit të prodhimit të energjisë elektrike ndërsa humbjet e energjisë në transimion dhe distribucion blihen në treg. Natyrisht, çmimet e rregulluara kanë mbetur te konsumatorët me pakicë për një periudhë të caktuar kohore.


Në kuadër të përmbushjes së obligimeve ligjore KOSTT gjithashtu ka finalizuar procesin e kalimit të prodhuesve nga burimet e ripërtitshme të energjisë nga furnizuesi tek KOSTT nëpërmjet nënshkrimit të kontratave për shitblerje të energjisë, e të cilat ju ofrojnë investitorëve siguri për investime. Për të bërë të mundshëm hapjen e tregut, punonjësit e përgatitur dhe profesional se bashku me menaxhmentin e KOSTT kanë dhënë kontribut të madh dhe kështu një fazë tranzitore është përmblyllur me sukses.

Aktualisht zhvillimet në sektorin e energjisë në Evropë janë mjaft dinamike dhe sfiduese për OST-të. Integrimi i burimeve të renovueshme të energjisë në shkallë të gjërë në nivelin e transimionit dhe distribucionit paraqet një sfidë për OST-të për të garantuar sigurinë e operimit të sistemit për shkak të shkallës së shumëllojshmërisë së këtyre burimeve. KOSTT është duke përcjellur dhe përgatitur rrjetin për integrimin e BRE-ve në sistemin e Kosovës dhe për me tej zhvillimin e projekteve duke përfshirë smart grid.

Zhvillimi i tregut të energjisë elektrike në nivelin nacional dhe regional ku tregu i përbashkët me Shqipërinë është hapi i parë, është po ashtu një sfidë tjetër e KOSTT për të bërë këtë treg operativ.

Gjatë vitit 2017 nëpër rrjetin transmetues të Kosovës janë transmetuar 8026 GWh energji elektrike, ku mbi 20.51% është energji e cila kalon si transit në rrjetin transmetues të Kosovës në drejtim të vendeve tjera.

Nëpërmjet mirëmbajtjes së rregullt dhe preventive është siguruar shkallë e lartë e disponueshmërisë dhe besueshmërisë së rrjetit transmetues. Zhvillimi i rrjetit të transimionit ka vazhduar sipas planeve investive në zhvillimin e rrjetit transmetues dhe në mbështetje të ngarkesës, kështu që në vitin 2017 janë realizuar investime në vlerë prej 19.9 milion euro, e cila ka rezultuar me një rritje të kapaciteteve transmetuese të cilat sipas kriterit N arrijnë vlerën 1700 MW dhe sipas kriterit N-1 1160 MW.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 7 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buscheti</i>

Planet zhvillimore dhe investive në KOSTT vazhdojnë të jenë prioritet dhe me këtë qëllim janë bërë përgatitjet për aranzhimet e reja të bashkëpunimit me KFW ku parashihen të financohet ndërtimi i Nënstacionit të ri 110/10kV Dragashi, Nënstacioni i ri 220/10kV në Malishevë, Linja Dragash-Kukës etj.

Përkundër zhvillimeve pozitive në KOSTT linja interkonektive 400kV Kosovë-Shqipëri ende është jashtë operimit teknik dhe komercial. Linja ndërshtetërore Kosovë Shqipëri u inaugurua në qershor të vitit 2016 në Tiranë, por për shkak të mos implementimit të Marrëveshjes për Kycje KOSTT/ENTSO-E kjo linjë nuk është komercializuar ende.

Marrëveshja për Kycje KOSTT/ENTSO-E ende nuk ka filluar që të implementohet. KOSTT ka vazhduar me përkushtim të theksuar angazhimet për sigurimin e pozicionit të merituar në mekanizmat ndërkombëtar, sfidë e cila po e përcjell KOSTT-in tashmë sa vite. Edhe pse nga aspekti teknik dhe operativ KOSTT është dëshmuar si OST kompetente dhe kjo është e verifikuar edhe nga grupi punues i themeluar nga ENTSO-E, KOSTT për shkak të pengesave politike që po i imponon operatori i transmisionit të Serbisë ende nuk funksionon si bllok rregullues. Megjithatë, kjo mbetet sfidë dhe synimi kryesor për menaxhmentin e kompanisë.

KOSTT mbetet i përkushtuar për të implementuar obligimet karshi Traktatit të Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore si dhe vazhdon me aktivitetet për përmbushjen e “masave të buta” në kuadër të procesit Western Balkans 6 Energy Connectivity Initiative.

KOSTT dhe OST e Shqipërisë, janë duke punuar në projektin për krijimin e Bursës Shqiptare të Energjisë (APE) ku KOSTT dhe OST Shqipëri do të jenë aksionar të barabartë.

Në përkushtimin për ngritjen e cilësisë së punës dhe ekselencës së biznesit, në vitin 2017 KOSTT ka arritur që të certifikohet me Standardin e Menaxhimit Mjedisor ISO 14001:2015, Standardin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë OHSAS 18001:2007 si dhe Standardin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015 duke u bërë kështu kompania e parë publike në Kosovë e certifikuar me këto tri standarde ndërkombëtare të cilësisë.

Performanca dhe stabiliteti financiar kanë bërë që KOSTT me kohë të përmbushë të gjitha obligimet financiare ndaj partnerëve afarist. Performanca e kompanisë është e treguar përmes koeficientëve të likuiditetit dhe koeficientët tjerë financiar të cilët janë mbi caqet e përcaktuara me objektivat strategjike.

Përkundër performancës teknike dhe afariste mjaft të suksesshme gjatë 11 muajve të periudhës raportuese, me 30 nëntor 2017 ZRRë në implementim të çështjes së ngritur nga Avokati i Popullit të formalizuar nëpërmjet procedurave gjyqësore, ka nxjerrë një vendim për të zvogëluar tarifat e KOSTT për 44%. Kësaj gjithashtu i është shtuar edhe pamundësia e liferimit të energjisë për mbulimin e humbjeve të KOSTT nga KEK. Këta dy faktor kanë ndikuar negativisht në performancën financiare të KOSTT në fund të vitit dhe do të vazhdoj edhe në tre muajt e parë të vitit 2018. KOSTT ka ndërmarrë masa preventive për të tejkaluar këtë situatë dhe besoj që rezultatet do të jenë evidente.


Në Raportin Vjetor që është prezantuar, ju mund të shihni një pasqyrë të përmbledhur të aktiviteteve, zhvillimeve dhe rezultateve të arritura gjatë vitit 2017 në KOSTT, të cilat kanë qenë të mundura falë përkushtimit profesional të punonjësve dhe mbështetjes nga Bordi i

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 8 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Drejtorëve, si dhe palët e interesit të cilët vazhdojnë të besojnë në profesionalizmin e dëshmuar të KOSTT.

Sinqerisht,

Kadri Kadriu
u.d.Kryeshef Ekzekutiv

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 9 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

1. Raporti i Bordit të Drejtorëve

1.1. Aktivitete kryesore të ndërmarra gjatë vitit

Përbërja aktuale e Bordit të Drejtorëve të KOSTT është caktuar me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës në pajtim me Ligjin për ndërmarrjet publike me vendimin 07/47 te datës 02.09.2015, ndërsa mbledhja konstituive është mbajtur me datë 25 shtator 2015. Sipas vendimit nr. 07/47 te datës 02.09.2015 Drejtorët e Bordit janë:

1. znj. Drita Konxheli-Radoniqi (Kryesuese),
2. z. Gani Jashari (anëtar),
3. z. Musa Misini (anëtar),
4. znj. Anita Cucovic (anëtare),
5. z. Afrim Prekazi (anëtarë),
6. z. Nebih Zariqi (anëtar),

Ministri i Zhvillimit Ekonomik në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike me vendimin 2402 i datës 06.10.2015, emëroi Komisionin e Auditimit, në përbërjen vijuese:

1. z. Afrim Prekazi (Kryesues),
2. znj. Anita Cucovic (anëtare),
3. z. Musa Misini (anëtar).


Ndërsa mbledhja konstituive e përbërjes së re të Komisionit të Auditimit është mbajtur me 22 tetor 2015.

Qeveria së Republikës së Kosovës me vendimin e Nr. 12/05; 14/05; 13/05, nga mbledhja e 5 e Qeverisë së Kosovës e datës 29 shtator 2017, të publikuar me date 3 tetor 2017 në ueb faqen e Kryeministrit të Kosovës ka shkarkuar tre Drejtor të Bordit të Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu - KOSTT, si në vijim:

1. znj. Drita Konxheli Radoniqi,
2. znj. Anita Cucovic
3. z. Musa Misini.

Sipas vendimit të Qeverisë nr. 07/47 te datës 02.09.2015 mandati aktual i Drejtorëve të Bordit është tri vite, pra skadon me 02.09.2018.

Për më tepër në gusht të vitit 2016 ka hyrë në fuqi Ligji për energjinë elektrike (Nr. 05/L – 085), i cili përcakton se të drejtat e aksionarit për KOSTT sh.a. ushtrohen nga Kuvendi i Kosovës.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 10 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


Për më tepër, në Nenin 62 të Ligjit për energjinë elektrike, përcaktohet se “Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, anëtarët aktual të Bordit të Drejtorëve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, përfshirë Kryesuesin, dhe Komisionin e Auditimit, vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre deri në përfundimin e mandatit të tyre të rregullt.”

Prandaj, përbërja aktuale e Bordit të Drejtorëve, përveç Kryeshefit Ekzekutiv (sipas detyrës zyrtare është edhe Drejtor Bordi, dhe ka marrëdhënie të rregullt të punës me ndërmarrjen), është si në vijim:


1. z. Gani Jashari (anëtar),
2. z. Afrim Prekazi (anëtarë),
3. z. Nebih Zariqi (anëtar),

Gjatë vitit 2017 Bordi i Drejtorëve të KOSTT ka mbajtur gjithsejtë trembëdhjete (13) mbledhje të rregullta, dhe dy (2) mbledhje të jashtëzakonshme. Bordi i Drejtorëve gjithashtu ka mbajtur edhe Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin.

Ndërsa Komisioni i Auditimit gjatë vitit 2017 ka mbajtur gjithsejtë njëmbëdhjete (11) mbledhje.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 11 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Nr.	Vendimet e Bordit për aprovimin e dokumenteve si vijon:
1	Raporti për tremujorin e katërt 2016 (TM4 2016)
2	Elaborati i regjistrimit vjetor të pasurisë për vitin 2016
3	Raporti Vjetor 2016
4	Raporti për kënaqësinë e konsumatorit për vitin 2016
5	Plani i punës së Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit për vitin 2017
5	Miratimi i Deklaratës për Politikën e Kompensimit për Drejtorët e Bordit dhe Zyrtarët e KOSTT
5	Raportet për tremujor për vitin 2017 (TM1, TM2, TM3)
6	Rishikimi i planit të biznesit dhe buxhetit për vitin 2017
7	Miratimi i Raportit të Auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare dhe Letrën e menaxhmentit për vitin 2017
8	Miratimi i planit të biznesit dhe Buxhetit për vitin 2018
9	Miratimi i Rregullores për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës alternative (passive/fijeve optike)
10	Vendimi miratimin e Skemës së re organizative (Makrostrukturës)
11	Miratimi I përshkrimit të vendit të punës për Zëvendës Kryeshef për Zhvillim
12	Miratimit i formularit për vetëvlerësimin e efektshmërisë
13	Vendimi për shpalljen e konkursit për Zëvendës Kryeshef për Zhvillim
14	Vendimi për emërimin e Zëvendës Kryeshefit për Zhvillim
15	Vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së Kryeshefit Ekzekutiv (shkarkimi i Kryeshefit)
16	Vendimi për Emërimin e Ushtruesit të Detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv
17	Miratimi i përshkrimit të vendit të punës për Kryeshef Ekzekutiv
18	Vendimi për shpalljen e Konkursit për Kryeshef Ekzekutiv
19	Vendimi për zgjatjen e afatit të konkursit për Kryeshef Ekzekutiv

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 12 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Përveç çështjeve dhe vendimeve të paraqitura më lartë, Bordi i Drejtorëve dhe Komisioni i Auditimit në ushtrimin e të drejtave dhe detyrave sipas Ligjit për ndërmarrje publike në vazhdimësi kanë shqyrtuar performancën e KOSTT, dhe kanë qenë mbështetës për menaxhmentin në arritjen e objektivave të përcaktuara në planin e biznesit.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për energjinë elektrike në gusht të vitit 2016 (Ligji Nr. 05/L – 085), si është përcaktuar në nenet 11, 12, 13, dhe 14 dhe në përmbushje të kërkesave të Pakos së Tretë të Bashkimit Evropian për shthurjen pronësore të Operatorit të Sistemit të Transmisionit, të drejtat e aksionarit për KOSTT ushtrohen nga Kuvendi i Kosovës, në kuptim të kësaj, siç është përcaktuar në Nenin 14 paragrafi 15, "Dispozitat e Ligjit për Ndërmarrje Publike, lidhur me kompetencën për emërimin e Bordit të Drejtorëve, ushtrimin e të drejtave të aksionarit, kompensimin e Bordit të drejtorëve dhe raportimin, dhe emërimin e Komisionit të Auditimit, nuk vlejnë për Operatorin e Sistemit të Transmetimit.", dhe të gjitha këto kompetenca ushtrohen nga Kuvendi i Kosovës. Megjithatë, Ligji për ndërmarrjet publike vazhdon të aplikohet për të gjitha çështjet tjera të cilat ndërlidhen me veprimtarinë e KOSTT.

Prandaj, në përmbushje të obligimeve ligjore nga data 6 Gusht 2016 të drejtat e aksionarit për ndërmarrjen publike Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu – KOSTT sh.a. ushtrohen nga Kuvendi i Kosovës. KOSTT vazhdon të operoj si ndërmarrje publike e organizuar në formën ligjore të shoqërisë aksionare.

1.3. Të dhëna për drejtorët jo-ekzekutiv

Gjatë vitit 2017 Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it ka qenë në përbërje si vijon:

znj. Drita Konxheli-Radoniqi, Kryesuese e Bordit të Drejtorëve, anëtare e Komisionit për operimin e tregut, Kryesuese e Komisionit për operimin e sistemit, me profesion ekonomiste Profesoreshë e lëndëve ekonomike në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës.


Gjithsej kompensimet 2017: € 13,158.45 + € 5,777.24 performanca për vitin 2016.

z. Gani Jashari, Drejtor i Bordit, Kryesues i Komisionit për operimin e tregut, anëtarë i Komisionit për operimin e sistemit, me profesion fizikant, Profesor i lëndëve fizike në Fakultetin e Fizikës në Universitetin e Prishtinës.

Gjithsejt kompensimet 2017: € 15,835.50 + 4,774.94 performanca për vitin 2016 .

z. Musa Misini, Drejtor i Bordit, Anëtarë i Komisionit të Auditimit, anëtarë i Komisionit për Operimin e Sistemit, me profesion inxhinier i elektros.

Gjithsejt kompensimet 2017: € 12,401.78 +€ 4,792.82 performanca për vitin 2016 .

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 13 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

znj. Anita Cucovic, Drejtore e Bordit, anëtare e Komisionit të Auditimit, anëtare e Komisionit për Çështje Ligjore dhe Rregullative, me profesion ekonomiste.

Gjithsejt kompensimet 2016: € 12,324.83 € + 4,792.82 performanca për vitin 2016 .


z. Afrim Prekazi, Drejtor i Bordit, Kryesues i Komisionit të Auditimit, anëtarë i Komisionit për çështje ligjore dhe rregullative, me profesion jurist.

Gjithsejt kompensimet 2017: € 16,313.40 + 4,774.94 performanca për vitin 2016.

z.Nebih Zariqi, Drejtor i Bordit, Kryesues i Komisionit për Çështje Ligjore dhe Rregullative, me profesion inxhinier.

Gjithsejt kompensimet 2017: € 15,697.80 +€ 4,774.94 performanca për vitin 2016.

Kompensimi përfshinë pagesën bazë si dhe kompensimin për shpenzimet e ushqimit dhe udhëtimit në vlerë prej €90 për mbledhje sipas vendimit të Bordit nr. 161013–II/4/1.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 14 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

1.4. Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe plani i vitit aktual

Performanca pozitive e afarizmit në KOSTT ka vazhduar edhe gjatë vitit 2017, duke u karakterizuar me zhvillime të shumta.


Gjatë vitit 2017 ka vazhduar përfshirja në infrastrukturën e SCADA\EMS, e elementeve të sistemit të cilat ishin zhvilluar pas implementimit të kësaj infrastrukture. Me këtë është mundësuar avancimi në ngritjen e funksioneve operative në monitorim dhe kontroll, veçmas në operimin e sistemit në kohën reale. Sistemi infrastrukturor SCADA\EMS, i Telekomit dhe Matjeve Komerciale ofrojnë mundësi shumë më të avancuara për operim të rrjetit transmetues në nivel të sigurisë së lartë, në baza planifikuese dhe në kohë reale, këmbimin e të dhënave midis objekteve elektro-energjetike, TSO-ve fqinje dhe Qendrës Koordinative.

Përkundër këtyre zhvillimeve pozitive edhe më tutje mbetet e pa përfshirë pjesa veriore e Kosovës, ku për shkaqe veç të njohura të pamundësisë së qasjes së lirë fizike, ende nuk është mundësuar përfshirja në këtë paket e NS Vallaçit dhe HC Ujmanit me NS Zubin Potok.

Përmes projektit në implementim “Përfshirja e të gjitha objekteve energjetike në kuadër të infrastrukturës së SCADA\EMS” edhe në vitin pasues do të vazhdojë përfshirja e nënstacionit në rehabilitim NS Theranda si dhe nënstacioneve të reja siç janë N.S. Drenasi 2, N.S. Prishtina 6 dhe N.S. Mitrovica 2, të gjitha këto që do të implementohen pas përfundimit të projektit të SCADA\EMS & Telekom.

Megjithatë, mbetet që për asetet e NS 110/x kV të kaluara nga KEK në KOSTT, duhet të zgjerohet niveli i kontrollit dhe monitorimit deri në kufirin aktual mes KOSTT dhe KEDS. Kjo do të funksionalizohet hap pas hapi dhe në vazhdimësi do të përfshihen edhe ndryshimet e tjera në rrjetin e transmetimit për shkak të zhvillimeve të rrjetit. Në këtë aspekt pritet që projekti i filluar i KEDS në SCADA sistemin e tyre të ndikoj në domosdoshmërinë e implikimeve tek infrastruktura e SCADA sistemit të KOSTT, veçmas aty ku aktualisht ekziston infrastruktura e përbashkët, që doemos ka implikime financiare, për të cilat KOSTT është duke përgatitur vlerësim konkret.

Gjatë vitit 2017 infrastruktura e SCADA\EMS dhe telekomit është avancuar duke krijuar zgjerimin e mundësive të shkëmbimit të observimit të rrjeteve transmetuese fqinje në kohë reale. Në këtë drejtim KOSTT, me kërkesën e OST-it (TSO e Shqipërisë) ka realizuar shtimin e shkëmbimit të të dhënave sipas TASE2 në drejtimin KOSTT – Qendra e re Emergjente OST (QDNE2). Shtimi është bërë nga personeli i KOSTT- sektorit SCADA/RTU duke kapërcyer implikimet financiare që do të krijoheshin me angazhimin e ndonjë kompanie të jashtme. Në vitin 2018 mbetet që observimi në kohë reale të finalizohet edhe me TSO e Malit të Zi CGES, ndonëse pjesa e punëve që tangon KOSTT-in, veç ka përfunduar.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 15 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Busheti</i>

Sa i përket vendosjes së grupeve matëse komerciale, gjatë vitit 2017 është arritur të përfundojnë dy projektet më të rëndësishme në fushën e matjeve komerciale në rrjetin e transmetimit: Projekti “Instalimit të Grupeve Matëse në kufirin e ri komercial KOSTT – KEDS/OSSH” si dhe Projekti “Nënstacionet – LOT 1 – Grupet matëse në Interkoneksion dhe Gjenerim”. Implementimi i këtyre dy projekteve të matjeve komerciale do të ndikoj drejtpërdrejt në rritjen e saktësisë së matjeve në kufi me gjenerimin, interkoneksionin dhe me rrjetin e shpërndarjes(KEDS) si dhe menaxhimin orar të energjisë duke përfshirë edhe llogaritjen e humbjeve orare të gjithë sistemit të transmetimit. Në kuadër të këtyre projekteve është instaluar edhe Qendra e re e matjeve(AMR) si dhe është instaluar sistemi rezervë(Backup) i matjeve i qendrës së AMR-së në EKCS.

Përkundër zhvillimeve pozitive në fushën e matjeve komerciale edhe më tutje mbetet e pa përfshirë pjesa veriore e Kosovës, ku për shkaqe veç të njohura të pamundësisë së qasjes së lirë fizike, ende nuk është arrit përfshirja e instalimit të grupeve të reja matëse në NS Vallaçi dhe HC Ujmani me NS Zubin Potok.

Tani, me vendosjen e infrastrukturës së re të grupeve matëse komerciale kemi përmirësuar në masë të madhe leximin e të dhënave orare të energjisë elektrike dhe saktësia e tyre në të gjitha pikat kufitare të rrjetit transmetues, duke realizuar qasje përmes përdorimit të Fibrave Optik në pronësi të KOSTT-it.


Gjatë vitit 2017 ka vazhduar të ketë kërkesa të shumta për krijimin e kushteve për implementimin e projekteve të reja dhe rehabilituese të rrjetit të transmetimit, për mirëmbajtje të planifikuar. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre kërkesave janë përcjellë me domosdonë e shkyçjeve të objekteve elektro energjetike, me ç ‘rast është zvogëluar ndjeshëm siguria e furnizimit të pandërprerë, kështu që ishte sfidë e vërtet për operimin e sistemit se si të bëjë koordinimin e gjithmbarshëm të këtyre shkyçjeve në aspektin brenda Kosovës si dhe në nivel rajonal. Përkundër këtyre rrethanave gjatë vitit 2017 është arritur që të mirëmbahet siguria e furnizimit dhe që kohëzgjatja e mos furnizimit të jetë e kontrollueshme.

Me qëllim të mbajtjes në gjendjen e duhur të aseteve, krijimin e sigurisë dhe besueshmërisë në funksionimin normal të tyre, KOSTT ka kryer punët e parashikuara operative në riparimin e pajisjeve elektroenergjetike.

Plani vjetor i mirëmbajtjes së linjave është realizuar 98% dhe i nënstationeve 95%.

Përveç kësaj janë zhvilluar edhe aktivitete tjera preventive, që kanë ndikuar në ngritjen e performancës së operimit të transmetimit. siç janë: kontrollimi vizual i stabilimenteve dhe operimi sipas kërkesave të QDN; realizimi i intervenimeve dhe evitimi i prishjeve; janë kryer specifikimet teknike për pjesë rezervë për mirëmbajtje, etj.

Mirëmbajtja e duhur dhe me kohë e pajisjeve elektroenergjetike, zhvillimi dhe zgjerimi i infrastrukturës me teknologjinë moderne, kanë krijuar një siguri të funksionimit të sistemit, si dhe janë krijuar kushtet për kujdesin më të madh ndaj ambientit që po ashtu është një nga prioritetet e KOSTT.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 16 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Performanca financiare e KOSTT-it, si edhe deri më tani, është mjaft e mirë dhe më detalisht është paraqitur në Pikën 2.3.5. të këtij Raporti.

Gjatë vitit 2017, indikatorët kyç të e performancës operative dhe financiare janë pozitive, prandaj mund të thuhet se KOSTT ka arritur caqet e parashtruara në objektivat e Planit të Biznesit për vitin 2017.

Bordi i Drejtorëve të KOSTT ka vlerësuar rregullisht këta indikatorë, të cilët kanë qenë pjesë e Raporteve të rregullta tremujore, të cilat janë dorëzuar në Njësinë për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike.


1.5. Pasqyrë e të pritave për vitin e ardhshëm

Ashtu si edhe deri më tani, përpjekjet e KOSTT-it, do të jenë të orientuara drejt realizimit të objektivave të saj strategjike (të cekura në pikën 2.4. të këtij Raporti), në përputhje të plotë me rolin, misionin dhe vizionin.


Zhvillimet kryesore që do të ndikojnë në KOSTT nga aspekti i operimit të sistemit gjatë vitit 2018, do të jenë:

- Legjislacionit sekondar i cili duhet të zhvillohet nga KOSTT dhe ZRrE në pajtueshmëri me kërkesat nga Ligjet e reja të Energjisë respektivisht: Ligji për Energji, Ligji për Energjinë (Ligji Nr. 05/L – 081) Elektrike (Ligji Nr. 05/L – 085) dhe Ligji për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L – 084) të aprovuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në qershor të vitit 2016.
- Implementimi i Marrëveshjes së Kyçjes me ENTSO-E;
- Fillimi i operimit të KOSTT si zonë rregulluese/bllok rregullues më vete në përputhje me rregullat e ENTSO-E;¹
- Aktivizimi i plotë i Marrëveshjes për rregullim sekondar me OST dhe KOSTT, ndërsa në këtë kontekst gjatë vitit 2017 është harmonizuar vetëm programi i testimit të AGC në mes të qendrës së re emergjente të OST me KOSTT, në afatin kohorë (18-20) Prill ;
- Pjesëmarrja aktive në grupet punuese rajonale si:
 - Pjesëmarrja në nëngrupin rajonal CMMI (Congestion Management and Market Integration);

¹ Mos defnimit konkret i përfshirjes së KOSTT në RSCI, ndonëse në vitin 2016 ka nënshkruar Marrëveshjen për themelimin e Qendrës Rajonale për Kalkulim të kapaciteteve RSCI me seli në Selanik, fillimi i operimit të kësaj qendre nuk ka filluar, si dhe nuk ka ndonjë afat të sakët se kur kjo do të ndodhë! Themeluesit e RSCI është menduar të jenë KOSTT (Kosovë), IPTO (Greqi), MEPSO (Maqedoni), TELAS (Turqi), ESO (Bullgari), OST (Shqipëri) dhe Transelectrica (Rumani) si observer. Pas një vlerësimi të kostos investive dhe asaj operative ka dalë që vlera financiare totale është 2.7 mil. €, që do të ndahet në numrin final të aksionarëve (TSO-ve).

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 17 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

- Pjesëmarrja në grupin punues TF SMTA (Task Force Short and Mid-Term Adequacy);
 - Pjesëmarrja në Grupin Punues rajonal për harmonizimin dhe koordinimin e shkyçjeve të Linjave Interkonektive për vitin 2018;
 - Pjesëmarrja në Grupin Punues rajonal për RSCI (Regional Security Coordination Initiative);
 - Pjesëmarrja në Grupin Punues në Projektin OPDE
 - Pjesëmarrja në Grupin Punues rajonal CGM;
- Implementimi i marrëveshjeve Ndër- OST me OST-të fqinje;
 - Implementimi i Mekanizmit Balancues si kërkesë në Dizajnin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë dhe Rregullave të Tregut;
 - Investimet në platformat softuerike, rifreskimi i atyre ekzistuese, trajnimi dhe edukimi i stafit për përdorimin e tyre. Platformat softuerike si SCADA/EMS, SME (Sistemin për Menaxhimin e Energjisë), Kontrolli Frekuencë Fuqi-LFC, analiza e sigurisë së operimit një ditë para i njohur si DACF- (Day Ahead Congestion Forecast), Paketi softuerik për analiza para operative NEPLAN, Softuer për mbikëqyrje dhe kontroll në kohën reale, pajisjeve të TL të tipit T 5000, E-TERRA Habitat, do të mundësojnë dhe lehtësojnë kryerjen e aktiviteteve të të gjitha palëve pjesëmarrëse në tregun e energjisë, për të siguruar operim më eficient të sistemit të energjisë elektrike;
 - Vazhdimi i investimeve në rrjetin e transmetimit për të arritur standarde të larta të shërbimeve ndaj klientëve dhe ngritja e efijencës së afarizmit financiar;
 - Shqyrtimi i aplikacioneve për kyçje ne sistemin e transmetimit, përgatitja e Marrëveshjeve të Kyçjes dhe nënshkrimi
 - Zgjerimi dhe ekspluatimi maksimal i infrastrukturës për monitorim dhe kontroll të SEE, me qëllim të shfrytëzimit optimal të kapaciteteve transmetuese që më saktësisht konsiston në ngritjen e nivelit të realizimit të kontrollit në objektet e rrjetit transmetues nga Qendra Nationale Dispeçerike Kryesore dhe Emergjente;
 - Përfshirja e të gjitha objekteve energjetike në kuadër të infrastrukturës së SCADA\EMS dhe i pajisjeve e fushave te instaluara me projekte te ndryshme ne RTU ne NS 110 kV;
 - Krijimi i kushteve teknike për monitorim të ndërsjellë me OST-të fqinje në kohën reale dhe shkëmbimi i informacioneve me Qendrën Koordinative Swissgrid me seli në Zvicër.
 - Ndërlidhja e domenit kostt_ost.com SME (Sistemin për Menaxhimin e Energjisë), kostt.com. AMR dhe zgjerimi i infrastrukturës se tij ne nënstatione për nevojat e mbikëqyrjes se pajisjeve digjitale (mbrojtjet rele, IED, BCU dhe SCS) për nevojat e Operatorit te Sistemit dhe Transmetimit.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 18 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buscheti</i>

Në aspektin e operimit, është i gatshëm implementimi i projektit të “Kontrollit Frekuence-Fuqi” në bashkëpunim me OST-në e Shqipërisë, i cili në mënyrë kuptimplote mund ta ndryshojë regjimin e operimit të sistemit elektrik që mund të reflektojë në tri variante, por që fillimisht do të aplikohet versioni i parë:

- Operimi si dy zona/Bloqe Rregulluese te veçanta me shkëmbim të shërbimeve ndihmëse,
- Operimi me dy zona të ndara por në një Bllok rregullues me Shqipërinë,
- Operimi në një zonë të përbashkët në faza të mëvonshme.

Edhe më tutje, KOSTT do të vazhdojë aktivitetet që lidhen me liberalizimin e Tregut të Energjisë elektrike në Kosovë. Aktivitetet e zhvilluara janë në përputhje me objektivat dhe kërkesat e qeverisë rreth liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës, kërkesat që dalin nga legjislacioni primar i sektorit të energjisë; kërkesat që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë dhe MSA-së ndaj hapjes së tregut të energjisë, si dhe në pajtim me Direktivat e Komisionit Evropian.

Më 1 prill 2016 ka hyrë në fuqi Marrëveshja e Stabilizim Asocimit, sipas së cilës, Kosova obligohet të përmbushë detyrimet që lidhen me integrimin në tregun e përbashkët rajonal (neni 114 i Marrëveshjes), ku ceket: “Në përputhje me acquis përkatës të BE-së, Palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin e tyre në fushën e energjisë në përputhje me parimet e ekonomisë së tregut dhe të Traktatit Themelues të Komunitetit të Energjisë, i nënshkruar në Athinë më 25 tetor të vitit 2005. Bashkëpunimi do të zhvillohet me synim të integritit gradual të Kosovës në tregjet Evropiane të energjisë “.


Gatë vitit 2018 pritet që Tregu i energjisë elektrike në Kosovë të operojë si zonë e pavarur tregtare. Në këtë mënyrë, Operatori i Tregut do ta operojë tregun e energjisë elektrike në përputhje me legjislacionin primar dhe sekondar si një zonë tregtare në vete.

Në aspektin e zhvillimit të tregut, do vazhdohet angazhimi rreth projektit për krijimin e një tregu të përbashkët Kosovë-Shqipëri.

Duke pas parasysh karakteristikat e tregut në Kosovë dhe Shqipëri dhe objektivat e qeverive për furnizim të sigurt me energji elektrike KOSTT, ZRrE, ERE dhe OST kanë diskutuar dhe analizuar idenë e bashkimit të dy tregjeve në një treg të përbashkët (një zonë tregtare). Tregu i përbashkët do të jepte sinjale të duhura për investime në kapacitete gjeneruese të reja dhe llojin tyre, për investime në rrjetin transmetues dhe të shpërndarjes, si dhe nga tregu i përbashkët do të përfitonin konsumatorët nga të dy vendet .

Tregu i përbashkët Kosovë- Shqipëri, gjithashtu do të mundësonte hapjen e tregut të energjisë elektrike dhe do të krijonte kushte për një treg konkurrues.

Themelimi i një tregu të përbashkët për të gjitha afatet kohore është në harmoni me objektivat e BE-së dhe Komunitetit të Energjisë si dhe iniciativës WB 6, e që mund të konsiderohet si hap drejt integritit në tregun rajonal të EJJL.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 19 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buscheti</i>

KOSTT-i do të vazhdojë të punojë me të gjitha kapacitetet e veta që si Operator i Tregut dhe i Sistemit, të sigurojë që të jetë plotësisht i integruar në të gjitha komponentët e tregut rajonal, të cilat aktualisht janë duke u zhvilluar. Në veçanti KOSTT-i do të:


- Përcjellë zhvillimet në rajon rreth tregut të energjisë elektrike;
- Përbushë obligimet që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë;
- Jetë pjesëmarrës aktiv në të gjitha organizatat relevante rajonale dhe evropiane që kanë të bëjnë me operimin e sistemit dhe tregut;
- Bashkëpunojë me Projekt Grupin për KOSTT (PG TSO KOSTT) të themeluar nga ENTSO-E, që të monitorojë përbushjen e standardeve të ENTSO- E nga ana e KOSTT;
- Vendosë marrëdhënie të qëndrueshme me OST-të e Evropës Kontinentale;
- Zhvillojë aftësitë e nevojshme për operimin e sistemit dhe tregut në nivel rajonal , duke shfrytëzuar ndihmën e konsulencës së financuar nga EBRD për këtë qëllim; dhe
- Kontribuojë në punën e SEE CAO (Coordinated Auction Office) dhe të angazhohet që kapacitetet interkonektive të KOSTT të alokohen nga SEE CAO, ku KOSTT është një nga themeluesit dhe aksionarët
- Kontribuoj në fillimin e punës operative të RSC

Ndërmarrja e masave dhe aktiviteteve të domosdoshme do të vazhdojë, në mënyrë që të sigurohet furnizim stabil dhe i sigurt me energji elektrike dhe ngritjen e performancës së tyre në nivelin e pranueshëm teknik.

KOSTT ka arritur që të ketë një siguri shumë më të lartë të operimit dhe mund të thuhet se performanca e arritur është mjaftë e kënaqshme. Këtë e dëshmon numri i rënive dhe intervenimeve, të cilat nga viti në vit kanë qenë në rënie dhe tani është arritur që të minimizohet numri i tyre, përkundër vjetërsisë dhe eksploatimit të tyre. Njëkohësisht, është duke u investuar në rehabilitimin e këtyre NS-ve sipas prioriteteve të caktuara në bazë të gjendjes funksionale të tyre. Sepse qëllimi kryesor i mirëmbajtjes është që të sigurojë një shkallë të lartë të besueshmërisë dhe sigurisë në sistemin elektroenergjetik. Kështu, përmes aktiviteteve të duhura në sistem, është arritur të krijohet një stabilitet i qëndrueshëm në funksionimin normal të sistemit. Duke iu falënderuar kësaj, si dhe investimeve të shumta, KOSTT tanimë gjendet në fazën e mirëmbajtjes preventive.

Planin e mirëmbajtjes për vitin 2018, KOSTT e ka përpiluar bazuar në Rregulloren e Mirëmbajtjes, i cili parashih të gjithë hapat e nevojshëm që duhet ndërmarrë në rrejetin transmetues, bazuar në praktikat më të mira profesionale si dhe sipas udhëzimeve të prodhuesve të pajisjeve elektroenergjetike , në mënyrë që të jenë funksionale dhe të garantojnë performancë të mjaftueshme për operim.

Prioriteti i KOSTT-it mbetet që të avancojë sistemin e mirëmbajtjes sipas standardeve më të larta, të cilat aplikohen në sistemet e avancuara, duke u bazuar në Rregullore dhe gjendjen e pajisjeve , në mënyrë që të kursethet koha dhe kostoja e mirëmbajtjes.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 20 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Për vitin 2018 janë planifikuar edhe një sërë aktivitetesh në shërbim të vizibilitetit të identitetit korporativ të kompanisë, me qëllim të ofrimit të qasjes më të lehtë deri tek informatat për palët e interesit është planifikuar ridizajnimi i faqes elektronike, realizimi i publikimeve të kompanisë, si dhe aktivitete të tjera në shërbim të përforcimit të raporteve me palët e interesit në vend dhe jashtë vendit, informimit të opinionit publik në lidhje me zhvillimet dhe aktivitetet e KOSTT, si dhe përkushtimin e mëtutjeshëm për zhvillimin e Përgjegjësisë Shoqërore të Korporatave (PShK/CSR) si një proces përmes të cilit KOSTT kontribuon në zhvillim të qëndrueshëm fillimisht përmes mënyrës se si operon, duke inkorporuar politikat e biznesit të përgjegjshëm në politikat e brendshme të kompanisë dhe më tutje duke ndërmarrë aktivitete në shërbim të komunitetit.

1.6. Informacione lidhur me kapitalin dhe dividendin

Kapitali themeltar i KOSTT-it në momentin e regjistrimit ka qenë 25.000 (*njëzetepesëmijë*) Euro dhe është i ndarë në 25.000 aksione me vlerë nominale 1 Euro secili. Kapitali i Shoqërisë është deklaruar dhe paguar tërësisht në momentin e themelimit të KOSTT-it .

Aksionari i vetëm i KOSTT-it është Qeveria e Republikës së Kosovës.

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital është dhënë në pikën 2.3.5. të këtij Raporti.

1.7. Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit


Në përputhje me Planin e Biznesit 2017 dhe Planin Zhvillimor të Transmisionit 2013-2017, investimet e planifikuara kryesisht kanë qenë në infrastrukturë për transmetimin e energjisë elektrike dhe janë përqendruar në:

- Përforcimet në rrjetin e transmisionit;
- Përkrahja e ngarkesës/nënstacionet e reja 110/10(20)kV ;
- Ri-vitalizimi i rrjetit të transmisionit;
- Projektet përkrahëse të operimit të sistemit të transmisionit (menaxhim, monitorim, matje dhe kontroll);
- Në përkrahje të zhvillimit dhe ndërtimit të autostradës Kosovë – Maqedoni; zhvendosja e shtyllave 400kV.


Viti 2017 karakterizohet si vit kryesisht ka qenë në realizimin e projekteve të filluara në vitet paraprake, të financuara nga KOSTT, KfW/KE dhe fillimi i projekteve të financuara nga BERZH/ kredi dhe buxheti vetanak i KOSTT-it . Sa i përket infrastrukturës së rrjetit të transmisionit në vitin 2017 nuk ka pas ndonjë projekt që ka filluar si projekt i ri .

KOSTT gjatë vitit 2017, ka qenë i fokusuar në plotësimin e obligimeve dhe detyrave në lidhje me përfundimin e implementimit të projekteve me kohë dhe buxhet, konform kushteve të kontratës për projektet në vijim :

- I. Projektet që kanë përfunduar në vitin 2017 dhe janë **në afat garantues** ;

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 21 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

- Paket Projekti "Përmirësimi i Rrjetit të Transmisionit, faza IV &V" të financuar nga KfW/KE dhe KOSTT:
1. Shërbimet Konsulente për mbikëqyrjen e punëve implementuese: "Përmirësimi i Rrjetit të Transmisionit faza IV &V"
 2. LOT 1 – Nënstacionet :
 - Ndërrimin e ndërprerësve të fuqisë në NS Prishtina 4, (afati garantues deri në Qershor 2019)
 - Rehabilitimin e NS 110/10kV Peja 1; GIS sistem, (afati garantues deri në qershor 2019)
 - Ndërtimin e fushave transformatorike në NS 400/110kV Ferizaj 2 dhe NS Peja 3 (e përfunduar afati garantues deri dhjetor 2018),
 - Instalimin e grupeve matëse në pikat interkonektive (afati garantues deri në dhjetor 2018);
 3. LOT2 –Transformatorët :
 - Furnizimi dhe instalimi i transformatorit të dytë energjetik TR2, 300 MVA në NS 400/110 kV, NS. Ferizaj 2 dhe NS. Peja 3 (afat garantues deri me dhjetor 2018)
 4. LOT 3 – Linjat Transmetuese
 - Ndërtimi i linjës së dyfishtë 110kV, NS Peja 1 – NS Peja 3 (në afat garantues deri në shtator 2018) :
 - Instalimi i OPGW në linjat interkonektive
 - Rehabilitimi i linjës 110kV, NS Peja 2 – NS Deçan (në afat garantues deri në shtator 2018) :
 5. LOT 4 - Rehabilitimi i 19 nënstacioneve (të përfunduara):
 - Ndërrimi i pajisjeve të TL (Tensionit të Lartë) dhe TM (Tensionit të Mesëm) në nënstacionet; Viti (afati garantues i përfunduar) ;
 - Furnizimi dhe instalimi i transformatorit të fuqisë 40MVA, në NS Lipjan si dhe ndërrimi i pajisjeve të TL (Tensionit të Lartë) dhe TM (Tensionit të Mesëm) në nënstacionet: Lipjan, (afati garantues deri dhjetor 2018) ;
 - Ndërrimi i ndarësve të fuqisë në NS 220/110kV Prishtina (afati garantues Shtator 2018)
 - Ndërrimi i shpenzimeve vetjake AC/DC në 19 nënstacione (afati garantues Shtator 2018) ;
 - Ndërrimi i Sistemit të kontrollit në NS Kosova B, NS Besiana dhe NS Prishtina 5 (afati garantues deri në Shtator 2018) ;

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 22 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

6. Përfshirja e të gjitha ndryshimeve në nënstacionet ekzistuese si dhe inkorporimi i nënstacioneve të reja në SCADA/EMS në Qendrën Dispeçerike dhe në Qendrën Emergjente Dispeçerike,;
7. Instalimi i grupeve matëse në kufirin e ri mes KOSTT dhe KEDS
8. Instalimi i TR 2 në NS 110/10(20) - Skenderaj dhe instalimi i TR në NS Burim.
9. Instalimi i transformatorit të tretë në NS 110/10(20) kV Prishtina 2 (projekti i përfunduar në janar 2017) ;
10. Revitalizimi i nënstacioneve 110kV, ana 35kV, NS Gjilani 1 dhe NS Ferizaj 1)(në afta garantues deri shtator 2018) :

II. Menaxhimi i projekteve, për të cilat janë nënshkruar kontratat dhe kanë filluar me punë implementuese gjatë vitit 2016 dhe vazhdojnë me implementim.

- Paket Projektet për të cilat janë nënshkruar kontratat në vitin 2016 dhe kanë vazhduar me implementim konform kontratave janë projektet, që financohen nga BERZH/kredi dhe buxheti vetanak KOSTT dhe të cilat duhet të zgjasin me implementim deri në Q2 2019:

11. Shërbimet konsulente për Menaxhimin e implementimin e Projektit e Zhvillimi i Transmisionit të Kosovës;
12. Shërbimet konsulente për ngritje të kapaciteteve;
13. LOT 1 – Nënstationet GIS: [110/10(20) kV – NS Prishtina 6 dhe 110 kV HIS në NS Prishtina 4], [110/10(20) kV – NS Mitrovica 2], [110/10(20) kV - NS Theranda] dhe [220/10(20) kV – NS Drenasi 2];
14. LOT 2 – Transformatorët e fuqisë: 40MVA; 2x40 MVA, në NS Prishtina 6, 2x40 MVA në NS Mitrovica 2 dhe 2x40 MVA në NS Drenasi 2 ;;
15. LOT 3 – Linjat transmetuese [linja 110 kV e njëfishtë, NS Rahoveci – NS Theranda], [linja 110 kV e dyfishtë dhe ajo kabllorike, NS Fushe Kosova], [linja 220 kV e dyfishtë Drenasi 2], [linja 110 kV e dyfishtë NS Mitrovica2] dhe [linja 110 kV e dyfishtë kabllorike, NS Prishtina 6 – NS Prishtina 4
** Projektet e lartshënuar kanë vonesa në implementim për shkak të vështirësive që po paraqiten në realizimin e procesit të shpronësimit, servitudit, marrjen e pëlqimeve dhe lejeve ndërtimore .

Në vitin 2017 KOSTT ka angazhuar stafin e vet në **Rilokimi i Linjave 110 dhe 400kV në SEG 3 të Autostradës Prishtine Shkup.**


Në kuadër të realizimit të Marrëveshjes së Kycjes për ndërtimin e Gjeneratorit me Erë KITKA, stafi i kostt ka përkrah dhe ka ndihmuar në realizimin e këtij projekti me kapacitet të prodhimit 32.5MW që pritet të përfundoj në vitin 2018.

Viti 2017 rezulton edhe me një mori aplikacionesh Kycje në Rrjetin e Transmisionit :

- Gjenerator me Erë , për ndërtimin e tre gjeneratorëve SELA1, SELAC 2 dhe SELAC 3, me kapacitet prej 105 MW
- Kycje_e Gjenerataorit me erë Bondcom Energy Point me kapacitet 3MW;

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 23 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

- "EV WIND PARK" sh.p.k me kapacitet 64.8MW:
- Gjeneratori me Ere "Koznica" me kapacitet prej 34.5MW
- Hidro gjenerator me kapacitet "Lepenci " me kapacitet 9MW
- Bejta Commerce&Bass-Com-Gllama- Solar 3 gjenerator me Diell (9MW) .

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 24 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2. Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv

2.1. Arritjet kryesore


Ashtu si viteve të kaluara, edhe gjatë vitit 2017, KOSTT ka dëshmuar edhe se është një organizatë e qëndrueshme dhe efektive, duke vazhduar me trendin e performimit pozitiv dhe duke zhvilluar një mori aktivitetesh që nga themelimi e deri më sot.

Një nga detyrat kryesore të KOSTT dhe në përputhje me objektivat e saj strategjike, mbetet edhe më tutje ofrimi i shërbimeve kualitative dhe të besueshme për përdoruesit e sistemit të transmetimit. Në këtë drejtim, trendi i performimit pozitiv ka vazhduar edhe gjatë vitit 2017.

Aktivitetet e operimit të sistemit janë zhvilluar, si vijon:

- Pjesëmarrja në nëngrupin rajonal CMMI (Congestion Management and Market Integration);
- Pjesëmarrja në grupin punues TF SMTA (Task Force Short and Mid-Term Adequacy);
- Pjesëmarrja në Grupin Punues rajonal për harmonizimin dhe koordinimin e shkyçjeve të Linjave Interkonektive për vitin 2018;
- Pjesëmarrja në Grupin Punues rajonal për RSCI (Regional Security Coordination Initiative);
- Pjesëmarrja në Grupin Punues në Projektin OPDE
- Pjesëmarrja në Grupin Punues rajonal CGM;
- Pjesëmarrja në Telekonferencën javore(WOPT) e Grupit Punues për Koordinimin e shkyçjeve të Linjave interkonektive dhe atyre të brendshme sinjifikative
- Përgaditja në bashkëpunim me CBA, e vlerësimit të statusit dhe adresimi i detyrave për KOSTT-in, të parashtruara nga ENTSO-E përmes PG TSO KOSTT
- Trajnimi i stafit operativ te Qendrës Dispeqerike Nationale sipas kërkesave nga doracaku ENTSO-E, në kuadër të POLICY nr 8 në koordinim me konsulencën Capacity Building Assistance –konzorciumi ELIAGRID&Pöry&EY, të financuar nga EBRD. Trajnimi është realizuar në Qendrën trajnuese GridLab në Berlin të Gjermanisë.
- Aktiviteti në përkrahjen e studimeve të ndryshme që zhvillohen nga konsulencia e financuar nga USAID “Re Power”.

KOSTT ka zhvilluar infrastrukturën e operimit të sistemit dhe tregut, janë zhvilluar dhe shumë nga kodet e domosdoshme teknike dhe rregullat e tregut dhe do të vazhdojnë të zhvillohen edhe në të ardhmen. Megjithatë, tani është me rëndësi për KOSTT-in që të përgatitet për sfidat e reja me të cilat do të përballet në të ardhmen. Një vend të

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 25 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

rëndësishëm në këtë drejtim zënë zhvillimet e tregut në Kosovë dhe rajon dhe një ndër objektivat e saj strategjike është edhe integrimi rajonal dhe arritja sa më e shpejtë e operimit si Zonë Rregulluese dhe anëtarësimit në ENTSO-E.

Gjatë vitit 2017 KOSTT ka vazhduar të jetë pjesë integrale e mekanizmit të ITC për qëllime të tranistit. Në këtë çështje ka pasur kooperim me trupat relevante të këtij mekanizmi dhe KOSTT-it në shkëmbimin e informacioneve të nevojshme.

Po ashtu, gjatë vitit 2017 janë mbajtur raporte pune me PG-TSO-KOSTT me ç'rast ne u jemi përgjigjur kërkesave të tyre për raportet periodike të ndryshme. Janë realizuar dy takime fizike së bashku me përfaqësuesit përgjegjës nga projekti Capacity Building Assistance të financuar nga EBRD, me qëllim të evaluimit të progresit të KOSTT kundrejt obligimeve që dalin nga katalogu i masave të vendosura nga ENTSO-E në kuadër të marrëveshjes së kyqjes KOSTT-ENTSO_E.



Gjatë vitit 2017 është realizuar përfaqësim i barabartë i KOSTT-it në Grupin Punues Rajonal të Mirëmbajtjes së kapaciteteve Interkonektive dhe atyre me ndikim të drejtpërdrejt në transmetim për Rajonin e Evropës Jug-Lindore, në kuadër të ENTSO-E.

Ky Grup Punues, ashtu siç e parasheh Doracaku i Operimit të ENTSO-E, Politika 4 (Planifikimi i Koordinuar Operativ), pos takimeve vjetore të organizuara nga Operatorët e Sistemeve Rajonale në principin e rotacionit, mbanë edhe Telekonferencën Javore WOPI ku raportohet për punën e Sistemit për javën e shkuar dhe planin për javën e ardhshme. Pra gjatë gjithë këtij viti është realizuar pjesëmarrja në telekonferencat javore(WOPI) e Grupit Punues për Koordinimin e shkyçjeve të Linjave interkonektive dhe atyre të brendshme me ndikime në rrjetin horizontal rajonal.

Implementimi i suksesshëm i mirëmbajtjes dhe projekteve do të ndihmojë në përmbushjen e objektivave themelore të KOSTT, në radhë të parë, në rritjen e kapacitetit të transmetimit, modernizimin e sistemit dhe mirëmbajtjen preventive, gjë që do të ndikojë në rritjen e besueshmërisë dhe sigurisë së sistemit, që është në përputhje me vizionin dhe misionin e KOSTT.

Gjatë këtij viti është realizuar 98% e planit vjetor të mirëmbajtjes së linjave,95% e mirëmbajtjes së nënstacioneve, si dhe janë zhvilluar aktiviteteve tjera të domosdoshme për sigurinë dhe stabilitetin e qëndrueshëm operativ dhe të sigurisë së sistemit elektroenergjetik.


Në vazhdim, është paraqitur disponueshmëria e linjave dhe nënstacioneve ne SEE gjate viti 2017:



Me qëllim të mirëmbajtjes sa më efektive, shfrytëzohet Rregullorja e Mirëmbajtjes e cila për bazë ka metodologjitë më të avancuara të qasjes në stabilimente duke marrë parasysh teknologjinë e përdorur si dhe afatet e duhura kohore për mirëmbajtje dhe shqyrtime të pajisjeve elektrike. Përmes kësaj synohet që oraret dhe aktivitetet në pajisje, të jenë sa më racionale duke u bazuar në gjendjen e pajisjeve. Në këtë mënyrë do të kursethet koha dhe kostoja e mirëmbajtjes.

Përkushtimi i KOSTT-it, për arritjen e objektivit të kompanisë siç është përgjegjësia në aspektin e sigurisë dhe mjedisit, ka vazhduar edhe gjatë vitit 2017, duke përmbyllur vitin:

- me certifikim pas auditimit të jashtëm për Menaxhimin e Sistemit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë OHSAS 18001:2007 dhe Menaxhimin e Sistemit të Mjedisit ISO 14001:2015
- me kujdesin për informim dhe trajnim të punëtorëve nga Zyra e Sigurisë dhe Mjedisit sipas programeve trajnuese në të cilat janë përfshirë 151 punëtorë apo gjithsej 302 orë trajnim, për periudhën 03 maj 2017 – 02 maj 2020

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 27 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Me qëllim të mbajtjes së një ambienti të sigurt dhe të shëndetshëm janë realizuar afërsisht 120 inspektime/monitorime të ndryshme dhe ka filluar matja e dëmtuesve fiziko-kimik, kushteve mikroklimatike dhe fushave elektromagnetike në vendin e punës, të cilat vazhdojnë edhe gjatë viti 2018.

Opinionit i auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare për vitin 2016 është pa asnjë kualifikim, edhe atë, për të njëmbëdhjetën herë radhazi, duke filluar qysh nga viti 2006. Kjo e arritur dëshmon më së miri punën profesionale dhe përkushtimin e KOSTT në zbatimin e standardeve më të larta në proceset e punës dhe përmbylljen me shumë sukses të shfrytëzimit të të gjitha resurseve. Veç kësaj, KOSTT ka kryer me kohë obligimet ndaj klientëve dhe Institucioneve të shtetit të Kosovës.

Sipas kërkesave ligjore, është përgatitur dhe është dërguar në ZRrE Raporti i Monitorimi të Kodit të Rrjetit në të cilin janë paraqitur rezultatet lidhur me implementimin e dispozitave nga Kodi i Rrjetit.

Gjatë vitit 2017, përmes të shkresës Njoftim për Mospajtueshmëri, nga ZRrE është vazhduar procesi i monitorimit të realizimit të shpenzimeve operative dhe të shpenzimeve kapitale. KOSTT ka përgatitur dhe i ka dërguar me kohe në ZRrE të gjitha të dhënat, sqarimet dhe dokumentet e kërkuara.

Në kuadër të përgatitjes së dokumenteve dhe amendamentimit për harmonizimin e kornizës rregullative me ligjet e reja të energjisë, janë përgatitur dhe janë dorëzuar në ZRrE dokumentet si në vijim:

Dokumentet e amendamentuara, të publikuara për diskutim publik dhe të aprovuara nga ZRRE:


- Metodologjia e Taksave të Kycjes në Rrjetin e Transmetimit
- Metodologjia për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (SHST)
- Metodologjia për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Sistemit
- Metodologjia për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Tregut

Dokumentet e përgatitura nga KOSTT dhe të aprovuara nga ZRRE:

- Metodologjia për llogaritjen e çmimit të jo balancit dhe çmimit të kompensimit
- Rregulla për ndërrimin e furnizuesit
- Procedurat për Blerje të Shërbimeve Ndhimëse

Pas hyrjes në fuqi të ligjeve të reja të energjisë, ZRrE gjithashtu ka inicuar procesin e amendamentimit dhe hartimit të legjislacionit sekondar dhe ka publikuar për diskutim publik të gjitha dokumentet për të cilat ka përgjegjësi ligjore. KOSTT sipas kërkesave nga ZRrE ka komentuar të gjitha dokumentet.

Sipas kërkesave nga legjislacioni primar dhe nga legjislacioni sekondar, dhe sipas afateve të përcaktuara nga ZRRE, KOSTT ka përgatit dhe i ka dorëzuar në ZRRE dokumentet dhe aplikacionet:

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 28 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

- Aplikacionin për të Hyrat e Lejuara Maksimale, raportin e realizimit për vitin 2016 dhe aplikacionin për tarifat/ngarkesat e energjisë elektrike që do të zbatohen nga data 1 prill 2017 deri më 31 mars 2018
- Aplikacionin për certifikimin e KOSTT si OST
- Planin pesë(5) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Transmetimit 2018 - 2022
- Plani pesë(5) Vjeçar Investues 2018 – 2022
- Aplikacionin për të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) me Formularët Raportues, të plotësuar me të dhënat ku janë paraqitur realizimet për periudhën 2013-2017 dhe propozimet për HLM për periudhën e dytë shumëvjeçare 2018-2022

Të arriturat e KOSTT, respektivisht, progresi që KOSTT ka bërë gjatë vitit 2017, janë paraqitur më detalisht në pikën 2.4 të këtij Raporti, i cili shqyrton implementimin e Planit të Biznesit për vitin 2017.


2.2. Ngjarjet kryesore të vitit

- **KOSTT sh.a fillon zbatimin e prokurimit elektronik** - Në përputhje me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 12/79 të datës 15.03.2016 dhe vendimit të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik nr.47/2016, nga muaji janar i vitit 2017 edhe KOSTT si kompani publike ka filluar me zbatimin e E-Prokurimit.

Qëllimi i prokurimit publik është që të siguroj vlerën më të mirë për paranë publike, duke respektuar rregullat që dalin nga Ligji i Prokurimit Publik në Kosovë, derisa përdorimi i sistemit elektronik garanton një proces transparent dhe siguron kushtet për një konkurrim të hapur ndërmjet operatorëve ekonomik pjesëmarrës.

- **KOSTT filloi me angazhimet përgatitore për implementimin e projekteve që bashkëfinancohen me BERZH** - Në kuadër të angazhimeve përgatitore për fillimin e implementimit të projekteve që bashkëfinancohen me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) në vlerë të përgjithshme prej € 36.5 milion, gjatë muajit janar 2017 KOSTT realizoi takime me Kryetarët e të gjitha komunave të cilat do të përfitojnë nga ky investim kapital. Nga ky investim do të përfitojnë komuna e Prishtinës, Fushë Kosovës, Drenasit, Rahovecit dhe Therandës.

- **Vazhdon përkrahja e SHBA në drejtim të reformave dhe arritjen e progresit në sektorin e energjisë në Kosovë** – Gjatë vitit 2017, KOSTT është vizituar disa herë nga zyrtarë të lartë të Departamentit të Shtetit, Ambasadës Amerikane dhe USAID të cilët kanë shprehur interesimin rreth progresit në integrimin e tregut të energjisë Kosovë-Shqipëri


	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 29 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

dhe pjesëmarrjes së Kosovës në bursën shqiptare të energjisë (APEX), projekte për të cilat KOSTT është përfitues i asistencës teknike të USAID-it, si dhe për sfidat me të cilat po përballet KOSTT në proceset e integrimi në mekanizmat rajonale dhe evropiane. Gjatë vitit 2017 KOSTT është vizituar nga: z. Justin Heung-zyrtar rajonal ekonomik në Byronë për Çështje Evropiane dhe Eur-Aziatike në Departamentin e Shtetit në Washington, i shoqëruar nga znj. Meredith Rubin-zyrtare e lartë për ekonomi në Ambasadën e SHBA në Kosovë, z. Dan Milstein-drejtori i Zyrës Rajonale Evropiane të Departamentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Energji, z. Steve Burns drejtor për energji dhe infrastrukturë për Evropë dhe Eurazi në Agjencionin Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), z. William Trigg zv.drejtor në zyrën për rritje ekonomike dhe zyrtarë të tjerë të lartë të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë dhe Agjencionit Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Misioni në Kosovë.

- Komisioni parlamentar për zhvillim ekonomik diskuton rreth sfidave me të cilat përballet KOSTT në integrimin në mekanizmat ndërkombëtar - Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në takimin që mbajti me datë 7 mars 2017, diskutoi rreth sfidave me të cilat po përballet KOSTT në proceset e integrimi rajonale dhe evropiane. Në këtë takim, Ministria për Dialog znj Edita Tahiri ka dhënë më shumë detaje për deputetët e Kuvendit të Kosovës në lidhje me moszbatimin e Marrëveshjes për Energji nga ana e Serbisë, dhe pengesave që po i bëhen KOSTT-it nga ana e Serbisë për të filluar me implementimin e Marrëveshjes për Këçje me ENTSO-E që i mundëson KOSTT-it operimin si zonë/bllok kontrollues i pavarur. Anëtarët e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, kanë shprehur shqetësimin e tyre për mos zbatimin e Marrëveshjes për Energji nga ana e Serbisë si dhe kanë sugjeruar që të merren masa konkrete për të ndikuar në zbatim të marrëveshjes.

-Delegacioni i KOSTT realizoi vizitë pune në OST Shqipëri - Me ftesën e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë, një delegacion i menaxhmentit të lartë të KOSTT realizuan vizitë pune gjatë muajit mars 2017 në Tiranë. Në fokus të kësaj vizite ishte njoftimi i KOSTT sh.a me përgatitjet e gjertanishme të OST Shqipëri, në drejtim të krijimit të bursës shqiptare të energjisë (APEX), pjesë e së cilës planifikohet të jetë dhe KOSTT, si dhe diskutimi rreth hapave të mëtejshëm bashkërendues.

- KOSTT pjesë e delegacionit në takimin e parë të MSA-së, Grupi i Veçantë për normalizim në Bruksel - Me datë 21 mars 2017 në Bruksel, delegacioni i Republikës së Kosovës nën udhëheqjen e Ministres për Dialog znj. Edita Tahiri, mbajti takimin e parë të Grupit të veçantë për normalizim në kuadër të Stabilizim Asocimit në mes të Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës. Në takimin e parë të Grupit të Veçantë për normalizim, i cili rrjedh si obligim nga Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim në mes të Kosovës dhe BE-së u bisedua rreth progresit dhe sfidave në implementim të Marrëveshjeve të arritura në kuadër të dialogut të Brukselit në mes të Kosovës dhe Serbisë, ku ndër të tjera është edhe Marrëveshja për Energji, e cila është në pritje të zbatimit.


	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 30 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buscheti</i>

- **KOSTT realizoi vizitë studimore në Operatorin e Sistemit të Transmisionit të energjisë elektrike të Sllovenisë – ELES** - Me qëllim të shkëmbimit të përvojave për operimin e tregut të energjisë elektrike, në muajin Mars 2017 KOSTT realizoi një vizitë studimore në kompaninë homologe të Sllovenisë, ELES. Në kuadër të kësaj vizite e cila u organizua nga projekti i USAID (Repower Kosova), u shkëmbyen përvojat në implementimin e mekanizmit balancues si dhe proceseve në operimin e sistemit transmetues dhe operimin e tregut të energjisë elektrike. Me homologët nga Sllovenia, gjithashtu u diskutua edhe për sfidat me të cilat po përballet KOSTT për fillimin e implementimit të Marrëveshjes për Kyçje me ENTSO-E me ç'rast u kërkua përkrahja e KOSTT në këtë drejtim.

- **KOSTT merr pjesë në edicionin e dytë të Forumit të Nivelit të Lartë për Energji “Strategjia e Energjisë dhe Liberalizimi i Tregut”** - Në Forumin e Nivelit të Lartë për Energji që u organizua për të dytin vit radhazi nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe USAID u diskutua mbi Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës 2017-2026 si dhe për liberalizimin e tregut të energjisë në Kosovë. Në kuadër të Forumit prezantuan edhe zyrtarë të lartë të KOSTT në lidhje me gjendjen aktuale të Sistemit Transmetues të Kosovës dhe rolin në ngritjen e sigurisë dhe besueshmërisë së furnizimit me energji elektrike nga aspekti i transmetimit, përgatitjet e nevojshme për procesin e liberalizimit të tregut si dhe obligimet që dalin për KOSTT-in nga Strategjia e re e Energjisë 2017-2026. Në Forum gjithashtu u adresuan edhe sfidat nëpër të cilat po kalon KOSTT si pasojë e mos implementimit të Marrëveshjes për Kyçje KOSTT-ENTSO-E me të cilën KOSTT bëhet zonë/bllok kontrollues i pavarur në kuadër të zonës sinkrone të Europës Kontinentale.

-**KOSTT realizoi vizitë studimore në Operatorin e Sistemit të Transmisionit të energjisë elektrike të Kroacisë – HOPS** - Në funksion të bashkëpunimit rajonal me operatorët e sistemeve transmetuese, delegacioni i KOSTT së bashku me përfaqësuesit e projektit mbështetës të USAID (Repower Kosova), në muajin prill 2017 realizuan vizitë studimore në Operatorin e Sistemit të Transmisionit të Kroacisë (HOPS). Në takimin i cili u realizua me përfaqësuesit e lartë të kompanisë homologe HOPS u diskutua për çështje bilaterale që ndërlidhen me operimin e sistemit transmetues dhe operimin e tregut të energjisë elektrike. Homologët nga Kroacia gjithashtu u njoftuan në lidhje me vështirësitë me të cilat po përballet KOSTT për integrim në mekanizmat ndërkombëtar si dhe u kërkua mbështetje për tejkalimin e sfidave në lidhje me implementimin e Marrëveshjes për Kyçje me ENSTO-E. Përfaqësuesit e HOPS shprehën interesimin për arsyet e mosimplementimit të marrëveshjes dhe njëkohësisht shprehën gatishmërinë për të përkrahur zbatimin e Marrëveshjes për Kyçje, në kuadër të kompetencave teknike dhe ligjore që kanë në rrjetin evropian të operatorëve të sistemit të transmisionit (ENTSO-E).

- **KOSTT nënshkruan memorandum bashkëpunimi me Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike të Universitetit “Hasan Prishtina”** - Në vazhden e

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 31 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buscheti</i>

partneriteteve që KOSTT ka lidhur me institucione vendore dhe ndërkombëtare që kanë për qëllim ngritjen e shkathtësive dhe zhvillimit profesional të të rinjve të Kosovës, që ata të jenë më të përgatitur për tregun e punës në të ardhmen, KOSTT ka nënshkruar edhe një memorandum bashkëpunimi me Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK) të Universitetit “Hasan Prishtina”. Ky memorandum bashkëpunimi ka për qëllim përkrahjen e ngritjes së kapaciteteve profesionale për studentët e FIEK, duke iu mundësuar atyre realizimin e praktikës profesionale në Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës.


Me këtë dëshmohet përkushtimi i KOSTT për të përmbushur zotimin e dhënë me nënshkrimin e Paktit Evropian të Rinisë në vitin 2016, projekt i lansuar nga CSR Europe (Bruksel), përmes Kosovo CSR Network në Kosovë nën Patronatin e Lartë të Kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe me mbështetje nga Ministria e Arsimit dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Përmes Paktit, palët nënshkruese zotohen që bashkërisht do të angazhohen për të krijuar partneritete me institucione arsimore për të krijuar mundësi të reja për punë praktike, trajnime, zanatësi dhe/ose punësim direkt për të rinjtë. Pjesë e këtij projekti janë edhe 28 shtete anëtare të BE.

- KOSTT ndër kompanitë e para publike vendore që certifikohet me tri standarde ndërkombëtare: ISO 14001:2015, OHSAS 18001:2007 si dhe ISO 9001:2015 - KOSTT sh.a, në vitin 2017 ka pranuar tri certifikata ndërkombëtare nga kompania britaneze QEC-EAS International Control and Certification. KOSTT u certifikua për herë të parë me Standardin e Menaxhimit Mjedisor ISO 14001:2015 si dhe Standardin e Sigurisë dhe Shëndetit në punë OHSAS 18001:2007, derisa që nga viti 2010 KOSTT është certifikuar në mënyrë të vazhdueshme me standardin ndërkombëtar për menaxhim të cilësisë ISO 9001:2008, derisa tani u certifikua me versionin më të ri të këtij standardi ISO 9001:2015. Me këtë, KOSTT bëhet kompania e parë publike në Kosovë e certifikuar me këto tri standarde ndërkombëtare të cilësisë.

Këto certifikata të vlerësuara globalisht, dëshmojnë përkushtimin e KOSTT për ngritjen e cilësisë së punës dhe ekselencës së biznesit në përputhje me standarde të përcaktuara ndërkombëtare.

- Pas përfundimit të fazës testuese, KOSTT filloi me implementimin e mekanizimit balancues - Ligji për Energjinë Elektrike përcakton obligimin e Operatorit të Sistemit të Transmisionit që të prokurojë shërbimet balancuese në një procedurë transparente, jodiskriminuese të bazuar në treg. Në përputhje me këtë, KOSTT/Operatori i Tregut ka zhvilluar “Metodologjinë për Llogaritjen e Çmimit të Jobalancit dhe Çmimit të Kompensimit” dhe nga data 1 tetor 2016 ka filluar fazën testuese të mekanizmit balancues pa implikim financiar “dry run”. Pas përfundimit të fazës testuese, sipas rekomandimeve të ZRrE-së nga data 1 qershor 2017 KOSTT ka filluar implementimin e mekanizmit balancues.

Mekanizmi balancues implementohet/operohet nga Operatori i Sistemit (KOSTT) kurse rregullat dhe funksionimi komercial, duke përfshirë kalkulimin e jo balanceve, i këtij mekanizmi është përgjegjësi e Operatorit të Tregut (KOSTT). Të gjithë pjesëtarët e tregut,

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 32 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

me skedulime të regjistruara te Operatori i Tregut (KOSTT), janë pjesë e mekanizmit balancues dhe janë përgjegjës për jobalancet që i shkaktojnë.

- **KOSTT nënshkruan marrëveshjen e parë me kompani vendore për shfrytëzimin e rrjetës së fibrave optik (dark fibre)** - Që nga viti 2004, paralel me zhvillimin e Sistemit Transmetues të energjisë elektrike, KOSTT po ashtu ka ndërtuar dhe zhvilluar rrjetin e ri telekomunikues të bazuar në fibra optik OPGW (Optical Power Ground Wire), me gjatësi prej 1109.38 km të vendosur nëpër largpërçues të tensionit të lartë, brenda gypave në bërthamën e të cilëve janë të vendosur nga 24 apo 48 fije optike.


Në përputhje me nenin 5.2 dhe 5.3 të Rregullores për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës alternative (pasive/fibër optike) dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, në muajin qershor 2017 KOSTT sh.a nënshkroi marrëveshjen e parë për ofrimin e shfrytëzimit me qira të rrjetës së fibrave optik (dark fibër/të pa-ndriçuar), me tre operatorë të licencuar të shërbimeve telekomunikuese. Shërbimi i Fibrave të pa-ndriçuar u mundëson operatorëve të lidhin teknologjitë e tyre përkatëse të transmetimit optik me fibrat e pashfrytëzuara të rrjetit të KOSTT-it, për të ofruar shërbimet e veta të transmetimit në relacionin Gjakovë – Prizren - Suharekë.

Kjo është marrëveshja e parë përmes së cilës KOSTT ofron shërbim të linjave me qira të fibrave optik, iniciativë e cila është mbështetur dhe inkurajuar nga Banka Botërore.

- **Institucionet e RF të Gjermanisë shprehin gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit të frytshëm me KOSTT edhe në të ardhmen** - Me 30 gusht 2017 KOSTT ka pritur në vizitë delegacionin e lartë nga Ambasada Gjermane, udhëhequr nga zv.Ambasadori i Republikës Gjermane në Kosovë z.Jan Axel Voss dhe drejtorin e Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) për Kosovë dhe Maqedoni z. René Eschemann. Në fokus të kësaj vizite ishte njohimi i delegacionit gjerman me gjendjen aktuale të Sistemit Transmetues të Kosovës, ndikimin e investimeve të vazhdueshme në zhvillimin e rrjetit të transmisionit, me theks të posaçëm atyre të Qeverisë Gjermane përmes KfW. “Zhvillimi i sektorit të energjisë në Kosovë është një nga prioritetet e Ambasadës Gjermane”, theksoi zv.Ambasadori Gjerman z.Voss, dhe me këtë rast shprehu gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit të frytshëm edhe në të ardhmen. Në takim, gjithashtu u diskutua në lidhje me sfidat me të cilat po përballet KOSTT si pasojë e mos implementimit të Marrëveshjes për Kyçe me ENTSO-E si dhe progresin në integrimin e tregut të energjisë Kosovë-Shqipëri.

Gjatë vitit 2017 KOSTT-in gjithashtu e ka vizituar edhe znj.Heike Backofen-Warnecke, Zëvendëssehefe e Divizionit për EJK dhe Kaukazin e Jugut në Ministrinë për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik të RF të Gjermanisë.

-**KOSTT merr pjesë në Seancën Dëgjimore për Shqyrtimin e Dytë Periodik Rregullativ** - Nën organizimin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRÉ), me 19 shtator 2017 në Prishtinë u mbajt seanca dëgjimore për Shqyrtimin e Dytë Periodik Rregullativ


	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 33 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buscheti</i>

(SHPRR 2), ku para të pranishmëve u prezantuan kërkesat për të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM/MAR) nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut-KOSTT sh.a dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes-KEDS. Pas prezantimeve rreth qëllimeve të shqyrtimeve shumëvjeçare të HLM dhe procesit e metodologjitë mbi të cilat mbështetet aprovimi i HLM-ve, para të pranishmëve mbajti prezentim u.d. Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Kadri Kadriu. z.Kadriu prezantoi të arriturat dhe performancën e KOSTT në përmbyllje të Periudhës 5 vjeçare rregullative, si dhe propozimet për të Hyrat e Lejuara Maksimale për periudhën e ardhshme të mbështetura me arsyeshmërinë si për investimet e planifikuara kapitale ashtu dhe për kostot operative, gjithnjë duke pasur parasysh rolin kyç të KOSTT në Sistemin Elektroenergjetik të Kosovës.

-Qeveria e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë zotohen për unifikimin e tregut të energjisë dhe pjesëmarrjen e KOSTT në APEX - Në takimin i cili u mbajt më 3 tetor 2017 në Tiranë në mes të Ministrit të Zhvillimit Ekonomik të Kosovës z.Valdrin Lluka dhe Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjetikës së Shqipërisë z.Damian Gjijnuri, u diskutua rreth procesit të krijimit të tregut të përbashkët të energjisë elektrike në mes të dyja vendeve, krijimit të bursës shqiptare të energjisë (APEX) si dhe sfidave që po e pengojnë vënien në operim të linjës së re interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri.

Në kuadër të takimit, Ministrat Lluka dhe Gjijnuri u dakorduan që të intensifikohen angazhimet e grupeve punuese drejt unifikimit të tregut të energjisë Kosovë-Shqipëri dhe emërimin e koordinatorëve të nivelit politik në kuadër të këtij procesi. Në kuadër të takimit, gjithashtu u konfirmua pjesëmarrja e KOSTT si aksionare në bursën shqiptare të energjisë (APEX), që është në proces të krijimit si dhe të dy ministrat u dakorduan që të harmonizohen veprimet në drejtim të zhblokimit të procesit për vënien në operim të linjës 400 kV Kosovë-Shqipëri, projekt i implementuar në bashkëfinancim me Qeverinë Gjermane përmes Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW).

-Investimi i mbi 3 milion EUR, bën Nënstacionin 110/35/10 kV Lipjani një nga Nënstacionet me siguri të lartë të furnizimit në Sistemin Transmetues të Kosovës- Nënstacioni 110/35/10 kV Lipjani i ndërtuar në vitin 1988, i furnizuar në mënyrë radiale nga Nënstacioni Prishtina 4, pas 29 viteve u revitalizua plotësisht në kuadër të LOT 4 të projektit “Përmirësimi i Rrjetit Transmetues-faza IV dhe V” i bashkëfinancuar nga KOSTT dhe Banka Gjermane për Zhvillim (KfW). Në përputhje me Planin Zhvillimor të Transmisionit 2017-2026, në dhjetor të vitit 2017 KOSTT sh.a përfundoi me sukses rehabilitimin e Nënstacionit 110/35/10 kV Lipjani duke realizuar kështu investimin në vlerë prej mbi € 3.1 milion. Me realizimin e këtij projekti është plotësuar kriteri i sigurisë së furnizimit N-1 në Nënstacionin 110/35/10 kV Lipjani duke e pozicionuar tashmë si një nga Nënstacionet me siguri të lartë të furnizimit në Sistemin Transmetues të Kosovës. Ky investim hap rrugë për zhvillimin e mëtutjeshëm ekonomik për rajonin e Lipjanit me rrethinë, si dhe rritë sigurinë e furnizimit nga aspekti i transmisionit për palët e kyçura, sidomos duke marrë parasysh që nga ky Nënstacion furnizohen me energji elektrike përveç konsumatorëve të nivelit distributiv, edhe Parku i Biznesit në Lipjan dhe në Shtime si dhe Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 34 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.3. Pasqyrë e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës

2.3.1 Bilanci i planifikuar dhe i realizuar për Janar-Dhjetor 2017

Detyra e operimit të sistemit gjatë vitit 2017 ka qenë mundësimi i implementimit të planeve paraprakisht të aprovuara të palëve tregtare sipas Bilancit 2017. Në vijim janë paraqitur disa të dhëna bazuar në analizën e bilancit së planifikuar dhe të realizuar, për periodën kohore të vitit 2017.


Vlerat janë sistemuar në formën tabelore për periudhën (Janar-Dhjetor), ku vlerat e planifikuara dhe të realizuara janë paraqitur në sasi të MWh, si dhe është treguar përqindja e realizimit në raport me planin për periudhën relevante.

Nga tabela e mëposhtme vërehet se prodhimi vendor ishte më i ultë se plani për 5,83%. Ka pasë ngritje të importit për 71,50% dhe zvogëlim të eksportit krahasuar me atë të planifikuar për 10,95%. Sa i përket neto konsumit të Kosovës ai ishte më i lartë se plani për 5,84%.

Humbjet në transmision kanë qenë më të ulëta për 4,41% krahasuar me ato të planifikuara, gjë që paraqet një performancë pozitive të sistemit.

Gjatë kësaj periudhe, KOSTT mundësoi realizimin e të gjitha planeve të miratuara të palëve tregtare si prodhuesve TC KEK, HC Ujmani, HC Lumbardhi, furnizuesit publik KESCO, konsumatorëve të mëdhenj të lidhur në rrjetin transmetues Ferronikeli, SharrCem dhe Trepça.


Të dhënat e planifikuara janë marrë nga dokumenti Balanca Vjetore e Energjisë Elektrike 2017, ndërsa të dhënat e realizuara nga pikat matëse dhe të transferuara në kufirin elektrik të rrjetit transmetues të Kosovës.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 35 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


Muajt MWh	Janar-Dhjetor 2017		
	E planifikuar	E realizuar	Real/Plan%
(1) TC Kosova A	1 981 964	1 934 059	97.58
(2) TC Kosova B	3 563 351	3 321 915	93.22
(3) Energjia për shpenzime vetanake (TC A+TC B)	0	0	
(4) HC Ujmani	95 000	88 173	92.81
(5) HC Lumbardhi	87 000	49 084	56.42
* (6) = 1+2+3+4+5 Prodhimi në hyrje të transmisionit	5 727 315	5 393 231	94.17
(7) Devijimi	0	- 25 437	0.00
(8) Eksporti	988 150	879 910	89.05
(9) Importi	724 350	1 242 225	171.50
(10) = 6-7-8+9 Energjia në disponim	5 463 515	5 780 983	105.81
(11) Distribucioni	4 564 440	4 704 643	103.07
(12) Ferronikeli	439 474	384 398	87.47
(13) Sharri	72 000	70 655	98.13
(14) Trepça	28 411	23 500	82.72
(15) Mihjet dhe konsum.jasht KEK	121 000	115 593	95.53
(16) Shpenzimet vetanake të TC nga transmisioni(LP290,B1,B2,T12,T34,T35,T45)	125 285	364 306	290.78
(17) = 11+12+13+14+15+16 Kërkesa neto	5 350 610	5 663 095	105.84
(18) Humbjet në transmission	112 904	117 888	104.41
(19) =17+18 Kërkesa gjithsej	5 463 515	5 780 983	105.81

Disa prej të dhënave kryesore të tabelës së mësipërme si kërkesa (konsumi) dhe prodhimi neto i Kosovës, importi dhe humbjet teknike në rrjetin transmetues të Kosovës janë ilustruar edhe në diagramin në vijim:

Bilanci i planifikuar Janar-Dhjetor 2017





Bilanci i realizuar Janar-Dhjetor 2017



Në diagramin e mëposhtëm në GWh, është paraqitur figurativisht bilanci i shpërndarjes së gjithë energjisë elektrike që hynë në rrjetin transmetues të Kosovës drejt destinacioneve për periudhën Janar-Dhjetor 2017.

Diagrami i balancës së realizuar elektroenergjetike Janar-Dhjetor 2017 (GWh)



	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 38 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


2.3.2. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i sistemit

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur vlerat konkrete të indikatorëve teknik të performancës së sistemit për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2017, të cilët janë treguesi më i mirë se si është implementuar plani i aprovuar i bilancit vjetor 2017, në krahasim me të njëjtën periudhë kohore të vitit paraprak 2016.

Nga rezultatet e fituara shihet se koha mesatare e mosfurnizimit të konsumatorëve ka qenë më e lartë gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2017, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2016, kjo si rrjedhojë e shkyçjeve në sistem për shkak të implementimit të projekteve për zhvillim të rrjetit të transmetimit.

- (T3) Koha mesatare e ndërprerjes ka qenë më e lartë, gjë që tregon se gjatë implementimit të projekteve për zhvillimin dhe rehabilitimin e rrjetit të transmisionit, janë bërë shkyçje të shumta, ku në disa raste është pamundësuar furnizimi i konsumatorëve me energji elektrike. Një sasi e energjisë së pafurnizuar ka qenë edhe për shkak të KEDS-KESCO.
- (T6) Vlera mesatare e devijimeve ka qenë në import (tërheqje nga sistemi) 9,66 më e lartë se në periudhën e njëjtë 2016, ndërsa eksport (shtyerje në sistem) 4,92% më e ultë se sa periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.
- (T7) Humbje teknike më të ulëta se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak për 2,13%.

Nr	Indikator				Caku	Komenti
		Janar-Dhjetor 2016	Janar-Dhjetor 2017	2017/2016(%)		
T1	Kapaciteti i Disponueshëm Mesatar Import/Eksport(AATC)					Do të aplikohet kur KOSTT fillon të funksionojë si zonë rregulluese
T2	Kapaciteti i Disponueshëm Maksimal Import/Eksport MATC					Do të aplikohet kur KOSTT fillon të funksionojë si zonë rregulluese
T3	Koha mesatare e ndërprerjes	181.2	380.0	209.76	Caku vendoset sipas raportit: (AIT	AIT ka qenë më e lartë gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2017,

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 39 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

	(AIT minuta/periudhën e raportimit)					për periudhën aktuale)/(AIT për periudhën e kaluar) < 1	krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2016 për 209,76%, për shkak të shkyçjeve të shumta dhe konfigurimit të rrjetit gjatë implementimit të projekteve.
T4	Numri i ankesave për tension		1	4		Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1	Caku për ankesa për tension duhet të ndërlidhet me numrin e ankesave në vitin (et) paraprak në periudhën e njëjtë dhe mundësia e zgjidhjes së ankesës duhet të jetë në kohë sa më të shkurtë.
T5	Numri i ankesave për matje		0	0			
T6	Vlera mesatare absolute e devijimeve orare Programi (MWh/orë)	Import	21.61	23.70	109.66	30MWh/h tërheqje jashtë programit të deklaruar	Stafi i Qendrës së Kontrollit ka për qëllim që devijimet mesatare absolute në orë të programeve të importeve/eksporteve të jenë sa më të vogla.
		Eksport	21.97	20.89	95.08	30MWh/h shtyrje jashtë programit të deklaruar	
T7	Humbjet në transmision (GWh)		120.46	117.89	97.87		Humbje teknike në transmision janë më të ulëta se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak për 2,13%

AATC-Average Available Transmission Capacity


MATC-Maximum Available Transmission Capacity

$AIT = (8760 * 60 * ENS) / TE$

ENS-Energy not supplied - EPF-Energjia e pafurnizuar

TE-Transmitted energy - ET- Energjia e transmetuar (Energjia që hyn në transmision) është energjia e cila hyn në transmision nga prodhimi i gjeneratorëve (Prodhimi në prag të transmisionit) dhe importeve si rrjedha fizike nga linjat interkonektive (import flow).

AIT- Average interruption time - KMR - Koha mesatare e rënieve.


	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 40 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.3.3. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i transmetimit

Nr	Indikator	Niveli i tensionit	*Koefficientet max në vitet(2011-2016)	2017	Krahasimi	Caku	Komenti
		kV		janar Dhjetor	2017/ Koefficientet max në vitet(2011-2016) (%)	<= 1	
T1	Numri i prishjeve në linja në 100km gjatësi	400	0.53	0.53	1	<1	
		220	1.3	0.43	0.330769		
		110	1.4	0.96	0.685714		
T2	Koha mesatare e riparimit të prishjes në linjë(orë)	400	5.35	5.35	1	≤1	
		220	3.11	0.47	0.151125		
		110	84.89	3.74	0.044057		
T3	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së linjës (minuta)	400	0	0	0	<1	
		220	0	0	0		
		110	0	0	0		
T4	Numri i prishjeve në transformator në 100 transformator(njësi)	400/220(110)	0	0	0	<1	
		220/110	0	0	0		
		110/35/10(20)		26			
			41.38		0.628323		

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 41 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

T5	Koha mesatare e riparimit të prishjes në transformator(orë)	400/220(110)	0	0	0	≤1	
		220/110	0	0	0		
		110/35/10(20)	15.28	15.28	1		
T6	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së transformatorit (minuta)	400/220(110)	0	0	0	<1	
		220/110	0	0	0		
		110/35/10	16.81	15.64	0.930399		
T7	Numri i prishjeve në stabilimente të TL në 100 fusha	400	0.01	0	0	≤1	
		220	0	0	0		
		110	5.66	5.66	1		
T8	Koha mesatare e riparimit të prishjes në stabiliment (orë)	400	4.25	0	0	<1	
		220	1	0	0		
		110	4.412	0	0		
T9	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së stabilimentit(fushës)(minuta)	400	0	0	0	< 1	
		220	0	0	0		
		110	0	0	0		
T10	Numri i prishjeve në mbrojtje rele/kontroll në 100 fusha	400	10	0	0	< 1	
		220	0	0	0		
		110	3.22	0	0		
T11	Koha mesatare e riparimit të prishjes në mbrojtje rele/kontroll (orë)	400	0.25	0	0	< 1	
		220	0	0	0		
		110	6.4	0	0		

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 42 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

T12	Koha mesatare shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së mbrojtjes rele/kontrollit (minuta)	400	0	0	0	<1	
		220	0	0	0		
		110	727.2	0	0		

2.3.4. Operimi i tregut


2.3.4.1 Madhësia e Tregut

Tregu i energjisë elektrike në Kosovë është treg bilateral ku tregu me shumicë është i parregulluar ndërsa tregu me pakicë është i rregulluar për furnizimin e konsumatorëve me të drejtë të shërbimit universal. Tregu është jo likuid ku mungon konkurrenca si në nivelin e tregut me shumicë po ashtu dhe atë me pakicë. Edhe pse ekzistojnë 3 furnizues të licencuar aktualisht vetëm KESCO bën furnizimin e të gjithë konsumatorëve të rregulluar dhe atyre të pa rregulluar .


Aktualisht konsumator të parregulluar janë vetëm konsumatorët e kyçur në rrjetin e transmisionit (Feronikeli i kyçur në nivelin 220kV, kurse Sharr-Cemi dhe Trepça në nivelin 110kV) ndërsa të gjithë konsumatorët tjerë janë pjesë e grupin e konsumatorëve me të drejtë të shërbimit universal). Gradualisht sipas afateve të përcaktuara nga ZRRë edhe konsumatorët e kyçur në nivelin 35kV dhe 10kV duhet të furnizohen me çmim të parregulluar dhe nuk do të jenë konsumatorë me të drejtë të shërbimit universal.

Nga 01.06.2017 ka filluar edhe implementimi i mekanizmit balancues ku palët të cilat dështojnë të përmbushin obligimet e tyre sipas nominimeve (obligimeve kontraktuale) paguajnë ose paguhen nga llogaria balancuese me çmimin e jobalancit. Të dhënat themelore energjetike janë dhënë në diagramet mëposhtme.

Tregu i rregulluar dhe pa-rregulluar




Energjia që ka hyrë në rrjetin transmetues



Energjia që ka dalë nga rrjeti transmetues dhe humbjet në transmision

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 44 nga 96</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

Pjesëmarrja e konsumit tarifor dhe jo tarifor



2.3.4.2. Hapja e tregut të energjisë elektrike në Kosovë dhe implementimi i Mekanizmit Balances

Me Vendimin e ZRRE qe duke filluar nga 01.04 2017 prodhimi i energjisë elektrike duhet të shitet në treg me çmim të pa rregulluar dhe me këtë fillon faza e parë e hapjes së tregut të energjisë elektrike në Kosovë. Duke pasur parasysh rrethanat e reja të krijuara me hapjen e tregut KOSTT ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për realizimin e udhëzimeve të lëshuara nga ZRrE duke bërë fillimisht krijimin e llogarive të energjisë për palët. Nga aspekti i llogaritjeve energjetike dhe të pagesave, menaxhohen këto llogari:

- Llogaria e prodhuesve BRE (6 llogari deri me tani)
- Llogaria injektuese e KELKOS (që në vete ka tri 3 llogari HC Deçani, HC Belaja dhe HC Lumëbardhi)
- Llogaria injektuese e KEK-ut
- Llogaria injektuese e HC Ujmanit
- Llogaria dalëse e KEDS për humbje në shpërndarje
- Llogaria dalëse e KOSTT për humbje në Rrjetin e transmetimit
- Llogaria dalëse e KOSTT për humbjet në Veri, (nga 2 dhjetori 2017 kjo llogari është jo funksionale)
- Llogaria dalëse për konsumatorët e rregulluar (Shërbimi Universal)
- Llogaria dalëse për konsumatorët e parregulluar të kyçur në nivelin 220kV (Feronikeli) dhe

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 45 nga 96</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

- Llogaria dalëse për konsumatorët e parregulluar të kyçur në nivelin 110kV (Sharrcem+Trepça).
- Llogaria për fondin BRE dhe
- Llogaria Balancuese

Llogaria e KelKos është ndare në tri llogari ku nga llogaria ekzistuese ndahen llogaritë për 2 hidrocentrale për HC Belaja dhe HC Deçani që trajtohen si prodhuese BRE.

Të gjitha Llogaritë përmbajnë shënimet për çdo periudhë të barazimit përfundimtar (për çdo orë) për energjinë e nominuar, energjinë e matur dhe obligimet financiare të llogaritura për çdo periudhë të barazimit përfundimtar. Në bazë të dhënave nga këto llogari krijohen raporte të cilat përdoren si bazë për faturimin e ndërsjella mes palëve në treg si dhe për faturimin e pagesës së jobalanceve.

Nga 1 tetor 2016 deri me 31.05.2017 është bërë testimi i mekanizmit balancues pa ndikim financiar, ndërsa nga 1 qershor 2017 ka filluar implementimi i mekanizmit balancues me ndikim financiar ku palët janë përgjegjëse për jo-balancet e shkaktuara.

KOSTT nga 1 Korrik 2017 bën kalkulimin e ndarjes së humbjeve për mbulimin proporcional të humbjeve në rrjetet përkatëse të KOSTT (përfshihen edhe humbjet në veri) dhe KEDS nga pjesa e mbetur e energjisë së prodhuar nga KEK (pas mbulimit të konsumit të shërbimit universal, Sharrcem dhe Trepça) dhe ky raport u dërgohet palëve çdo mëngjes deri në orën 09:00 në mënyrë që KESCO të importojë diferencën e pambuluar nga KEK për USS, KEDS dhe KOSTT.

KOSTT ka nënshkruar Marrëveshjen me KESCO për blerjen e diferencës së humbjeve të pa mbuluara nga KEK për periudhën 01.04.2017-31.08.2017 ndërsa marrëveshja për blerjen e humbjeve nga KEK është nënshkruar nga KOSTT për periudhën 01.04.2017 deri me datën 31.03.2018.

KOSTT ka përpiluar Procedurat për blerjen e energjisë (për periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë) të cilat janë dërguar për miratim në ZRRë. Bazuar në këto procedurat KOSTT ka nënshkruar Kontrata Kornizë me palë të kualifikuara për Blerjen e Humbjeve në bazë të së cilës palët do të marrin pjesë në ankandin e organizuar nga KOSTT për të dhënë ofertat e tyre. Pala me ofertën më të lirë është përzgjedhur si fituese dhe është nënshkruar kontrate individuale ditore me palën fituese.

KOSTT ka filluar me organizimin e ankandit për blerjen e humbjeve transmetuese më 31 gusht 2017 për datën vijuese 1 shtator 2017.

Ligji për Energjinë Elektrike LIGJI Nr. 05/L – 085 ndër tjera obligon Operatorin e Tregut për shitblerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga BRE-të. Nga periudha 01.06.2017 deri sa është bërë transferi i kontratave nga KESCO tek Operatori i Tregut, KESCO ka vazhduar të paguajë prodhuesit BRE për energjinë e matur të liferuar nga prodhuesit BRE sipas marrëveshjeve në fuqi të cilën kosto e ka mbuluar KOSTT. Prodhuesit BRE janë përgjegjës për 25 % të jobalanceve të tyre pozitive dhe negative.

Nga 1 Qershori Prodhuesit BRE kanë filluar me nominimin e prodhimit të tyre tek OT në D-1 me të drejtë të rinominimit deri në 3 ora para kohës reale të prodhimit të tyre. Ndërsa OT bënë nominimin e energjisë së blerë nga BRE të pranuar në Skemën Mbështetëse si transaksion mes KOSTT(OT) dhe KESCO. KOSTT i ka lëshuar faturë KESCO për tarifën e fondit BRE për mbulimin e diferencës së koston me çmimit referent dhe çmimit me tarifë nxitëse dhe faturën për shitjen e energjisë që e ka blerë nga BRE-të.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 46 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


OT u lëshon faturë prodhueseve BRE për pagesën 25% të jobalanceve të shkaktuara nga ana e tyre në emër të fondit BRE. Ndërsa 75% e jobalanceve të shkaktuara nga BRE mbulohen nga tarifa për fondin BRE që e paguajnë furnizuesit (aktualisht KESCO). BRE kanë shprehur vërejtjet e tyre me implementimin e obligimeve të reja në lidhje me nominimin dhe obligimin për 25% të jo-balanceve të shkaktuara por kanë kryer obligimet e tyre për jobalancet e shkaktuara. BRE-të në skemën mbështetëse janë dhënë në tabelën e mëposhtme:

Nr . ren	Emri i BRE-së	Adresa:	Lokacioni	BRE	Kapaci teti i Instaluar	Data e Dhënies së	Gjendja e MB-së	Data e nënshkruimit të	Data e fillimit të implementimit të
1	"Eurokos J.H." sh.p.k.	20. Zenun Beqa,	Lumi Restelica HC Brodi II. KK Dragash.	Gjenerim i energjisë nga uji/	4,8 MW	24.10.2013/ në operim	MBE nga KESCO në KOSTT	24.10.2017	01.11.2017
2	"Eurokos J.H." sh.p.k.	20. Zenun Beqa,	Lumi Restelica HC Restelica I & Restelica II.	Gjenerim i energjisë nga uji/	2,28 MW	24.10.2013/ ne operim	MBE nga KESCO në KOSTT	24.10.2017	01.11.2017
3	"HYDRO-LINE" SH.P.K.	Mbretresha Teutë	Lumi Bistrica, HC Albaniku 3 (Dolac)	Gjenerim i energjisë nga uji/	4,27 MW	24.10.2013/ ne operim	MBE nga KESCO në KOSTT	27.10.2017	01.11.2017
4	"MATKOS GROUP" SH.P.K.	Veterni k p.n. Prishtin	Lumi Lepenc HC Brezovica, Komuna e	Gjenerim i energjisë nga uji/	2,1 MW	26.01.2016/ ne operim	MBE nga KESCO në KOSTT	27.10.2017	01.11.2017
5	LED LIGHT TEHNOLOGJY	Ulpiana C2, Hyrja	Gjurgjevik/Mali shevë, KK Klina, Republika	Gjenerimi nga energjia	0,1 MW	03.10.2014 në operim	MBE nga KESCO në KOSTT	26.10.2017	01.11.2017
6	"ONIX SPA" L.L.C.	Adresa rr. M. Maksut	Lokacioni - Banja e Pejës, ZK Istog, KK	Gjenerimi nga energjia	0,5 MW	28.01.2016 në operim	MBE nga KESCO në KOSTT	27.10.2017	01.11.2017
7	"SOLAR GREEN ENERGY"	Adresa "Luan Haradin	Novoselë, KK Kamenica, Republika e	Gjenerimi nga energjia	3 MW	Autorizimit Final nga ZRrE,	MBE me KOSTT	01.11.2017	Në përputhje me Nenin 2
8	N.T.N. "RENELUAL TAHIRI"	Rruga e Jonit nr. 92/2,	Lokacioni HC Orqusha (Rapçe - Plava),	Gjenerim i energjisë nga uji/	4 MW	Autorizimit Final nga ZRrE,	MBE me KOSTT	08.11.2017	Në përputhje me Nenin 2
9	"MATKOS GROUP" SH.P.K.	Veterni k p.n. Prishtin	Lumi Lepenc HC Sharri, Komuna e	Gjenerim i energjisë nga uji/	6,45 MW	Autorizimit Final nga ZRrE,	MBE me KOSTT	10.11.2017	Në përputhje me Nenin 2
10	"MATKOS GROUP" SH.P.K.	Veterni k p.n. Prishtin	Lumi Lepenc, HC dhe HC Vica, Komuna e	Gjenerim i energjisë nga uji/	4,6 MW	Autorizimit Final nga ZRrE,	MBE me KOSTT	10.11.2017	Në përputhje me Nenin 2
11	"MATKOS GROUP" SH.P.K.	Veterni k p.n. Prishtin	Lumi Lepenc, HC "Shterpca, Komuna e	Gjenerim i energjisë nga uji/	5,03 MW	Autorizimit Final nga ZRrE,	MBE me KOSTT	10.11.2017	Në përputhje me Nenin 2
12	"HIDROENERGJI" SH.P.K.	Dëshmorët e Kombit	Lumi Lepenc, HC Lepenci 1; Uji i Thartë,	Gjenerim i energjisë nga uji/	9,98 MW	28.01.2016 skadon/e	MBE me KOSTT	13.12.2017	Në përputhje me Nenin 2
13	"HIDROENERGJI" SH.P.K.	Dëshmorët e Kombit	Lumi Lepenc, HC Lepenci 3, (Sllatinë),	Gjenerim i energjisë nga uji/	9,98 MW	28.01.2016 skadon/e	MBE me KOSTT	13.12.2017	Në përputhje me Nenin 2

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 47 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Vështirësitë në lidhje me implementimin e procesit të hapjes së Tregut

Me vendimin e hapjes së tregut të energjisë elektrike nga ZRRE nga 01.04.2017 procesi është shoqëruar me vështirësi të madhe. Vlen të theksohet se mos arritja me kohë e marrëveshjeve mes palëve për shitblerjen e energjisë me çmim të parregulluar sipas udhëzimeve të ZRrE , nominimit për humbjet në rrjetin e transmetimit, humbjeve në sistem dhe humbjeve në shpërndarje, janë bërë vetëm me KESCO prandaj në mënyrë retroaktive OT ka bërë rialokimin e energjisë për mbulimin e humbjeve e cila është mbuluar nga KEK dhe nga Importi. Për muajin Prill dhe Maj rialokimi është bërë në bazë të vlerave të matura ndërsa për muajin qershor 2017 dhe korrik 2017 në bazë të vlerave të nominuara.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 48 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.3.5. Pasqyra e performancës financiare dhe rezultatet

DRAFT.			
BILANCI I GJENDJES			
12/31/2017			
	Note	2016 (EUR 000)	2017 (EUR 000)
Palujtshmerite, impiantet dhe pajimet	4	146,948	168,943
Investimet ne vijim	5	27,807	12,878
PASURITE JO QARKULLUESE		174,755	181,821
Stoqet,pjeset rezerve dhe veglat	6	3,499	3,968
Arketueshmerite dhe kerkesat tjera	7	2,238	2,077
Kerkesat nga jo balansat			428
Huate,avanset dhe depozitat	8	10,993	8,799
Ndarjet kohore aktive			46
Paradhanje për Tatim në fitim.		306	224
Depozitat ne banka		22,000	18,300
Paraja ne arke dhe bilanci bankar	9	952	9,514
PASURITE QARKULLUESE		39,988	43,356
		214,743	225,177
KAPITALI AKSIONAR DHE REZERVAT			
Kapitali aksionar	10	25	25
Kapitali i trashëguar	11	53,332	53,333
Fitimi per periudhen e meherisl		29,908	36,047
Fitimi për periudhë.		6,138	2,426
		89,403	91,831
DETYRIMET JO KURENTE			
Te hyrat e shtyera	12	84,140	75,158
Obligimet Për Kredi	14	25,256	47,461
DETYRIMET KURENTE			
Pagueshmerite dhe obligimet tjera	13	15,944	10,299
Obligimet nga jo balansat			428
		125,340	85,885
		214,743	225,177
Zyrtari Kryesor Financiar.			Kryeshefi Ekzekutiv

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 49 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

DRAFT PASQYRA E TË ARDHURAVE

(EUR 000)

	Realizimi Janar-Dhjetor 2016	Buxheti Janar-Dhjetor 2017	Realizimi Janar-Dhjetor 2017	% realizimit ndaj buxhetit
Të hyrat nga rrjeti 220 /400 kV	587	533	542	102%
Të hyrat nga rrjeti 110 kV	15,213	13,441	12,910	96%
Të hyrat nga sistemi i operimit	6,723	5,245	4,893	93%
Të hyrat nga operatori i tregut	416	446	413	93%
Të hyrat për humbje nga përshtatjet e KEK		6,446	4,771	74%
Të hyrat për Burimet e Ripërtëritshme		3,900	4,995	128%
Gjithësejt të hyrat nga tarifat	22,939	30,011	28,524	95%
Të hyrat tjera operative	125	40	31	79%
Të hyrat nga interesi	330	100	363	363%
Të hyrat nga grantet për shërbime (cap. b)	30	525	714	136%
Të hyrat nga inbalanca	-	-	217	
Të hyrat nga tranziti	335	340	120	35%
Të hyrat e shtyera	7,096	7,850	6,940	88%
Gjithësejt të hyrat	30,826	38,866	36,910	95%
Shpenzimet operative	11,684	23,744	21,744	92%
1 Mirëmbajtja	753	1,237	686	55%
2 Shpenzimet e stafit	5,040	5,452	5,016	92%
2.1 Pagat	4,367	5,092	4,712	93%
2.2. Kontrata në vepër	126	180	162	90%
2.3 Përformanca e planifikuar	546	180	141	79%
3 Shpenzimet tjera operative	1,393	1,579	1,209	77%
4 Humbjet në Veri të mbuluara nga KEK	-	5,619	-	0%
5 Humbjet në bartje	3,916	4,235	10,972	259%
6 Shpenzimet e interesit	390	699	693	99%
7 Shpenzimet e konsulencesn (cap. b)	30	525	714	136%
8 Shpenzimet e tranzitit	164	240	48	20%
9 Shpenzimet per Burimet e Ripërtëritshme	-	3,900	1,670	43%
10 Kostot operative per RSC	-	258	-	0%
11 Shpenzimet nga inbalanca	-	-	736	
Fitimi para amortizimit	19,141	15,122	15,166	
Amortizimi	12,321	13,664	12,740	93%
Gjithësejt shpenzimet (operative+ amortizimi)	24,005	37,408	34,484	
Fitimi para tatimit	6,821	1,458	2,426	
Tatimi në fitim	682		-	
Neto Fitimi / Humbja	6,139	1,458	2,426	

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 50 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

DRAFT.		
PASQYRA E RRJEDHES SE PARASE		
	Viti Paraprak 2016	Viti Tanishëm 2017
	EUR	
RRJEDHA E PARASE NGA AKTIVITETET OPERATIVE	(EUR 000)	(EUR 000)
Fitimi para tatimit	6,821	2,426
Pershtatjet per:		
Te hyrat nga interesi	(330)	(333)
shpenzimet e interesit	390	693
	(8)	
Amortizimi	12,320	12,740
Te hyrat e shtyera	(7,066)	(6,940)
Rrjedha operative e parase para rregullimeve ne kapitalin punues	12,127	8,586
Rritje/zvoglim ne stoqe,pjese rezerve dhe vegla	(154)	(470)
Rritje/zvoglim ne Arketueshmeri dhe kerkesa tjera	370	121
Rritje/zvoglim ne hua,avanse dhe depozites	(1,612)	2,195
Rritje/zvoglim ne pagueshmeri dhe obligime tjera	4,855	(5,651)
Gjenerimi i parase nga aktivitetet operative	15,586	4,781
RRJEDHA E PARASE NGA AKTIVITETET INVESTIVE		
Kthimi I kredis	(2,789)	(3,579)
Grantet e pranuar	10,764	2,761
Kredia e pranuar	3,384	21,173
	(390)	(693)
	(990)	3,700
Intersi i pranuar	330	333
Blerja e asetëve të reja	(30,370)	(19,913)
Paraja neto nga aktivitetet investive	(20,061)	3,782
Rritja neto e parase dhe ekuivalenteve te parase	(4,475)	8,563
Paraja dhe ekuivalentet e parase me (2016-12-31)	5,426	951
Paraja dhe ekuivalentet e parase me (2017-12-31)	951	9,514

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 51 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2017

	Kapitali aksionar	Kapitali i trashëguar	Fitimi i mbajtur	Total
000 euro				
Kapitali aksionar në para	25			25
				-
Kontributet tjera jo para		53,333		53,333
Fitimi për periudhën e mëhershme			36,047	36,047
Fitimi për periudhë			2,426	2,426
Bilanci me DATA	25	53,333	38,473	91,831

Sqarim:

Draft Raporti Financiar për vitin 2017 është:


- pa efektet e elaboratit të regjistrimit
- pa efektet e rregullimeve për tatimin në fitim
- pa efektet e rivlerësimit të tokave, të cilat janë në proces dhe të cilat e ndërrojnë gjendjen e Bilancit të Gjendjes dhe Ndryshimeve në Ekuitet

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 52 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.3.6. Analiza e IKP-ve financiare

Në vazhdim, janë dhënë IKP-të që paraqesin performancën financiare të KOSTT-it gjatë vitit 2017

Treguesit	I-XII 2016	I-XII 2017	Shpjegimet
T1. Fitimi operativ marginal = Fitimi neto /gjithsejtë të hyrat	0.20	0.07	<p>Qëllimi është që të jetë mbi zero.</p> <p>Është treguesi i cili më së miri paraqet nivelin e të hyrave nga operacionet vijuese.</p> <p>Ky tregues matë se çfarë përqindje e të hyrave të kompanisë, mbetet pasi që ajo t'i paguaj të gjitha shpenzimet variabile si: pagat, materialet, shërbimet, etj. Sa më i lartë është ky tregues, kompania është në gjendje më të mirë.</p>
T2. Treguesi i likuiditetit = kapitali punues/detyrimet qarkulluese	2.51	4.04	<p>Përcakton aftësinë e kompanisë për të paguar detyrimet e saj afat shkurta. Sa më e lartë është vlera e këtij treguesi, aq më e lartë është siguria që kompania posedon mjete për të mbuluar borxhet afatshkurta.</p> <p>Treguesi duhet të jetë më i madh se 1.</p>
T3. Treguesi i qarkullimit të kërkesave =kërkesat *365 ditë/të hyrat	34	31	<p>Ky tregues është i matshëm në baza vjetore</p> <p>Caku: ≤ 90 ditë</p>

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 53 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

T4. Treguesi i efektit te kapitalit te investuar (ROCE) = fitimi neto/mesatarja e kapitalit të investuar mesatarja e kapitalit të investuar = Total asetet- obligimet	3.87	1.42	Tregon eficiencën dhe profitabilitetin e investimeve kapitale të kompanisë. Sa më i madh është fitimi operativ marginal, aq më i madh është ky tregues. Caku: > 0
T5. Giring = kreditë afatgjate jashtë vendit/kapitali*100	30.33	53.09	Ky tregues tregon raportin mes borxhit total afatgjatë dhe kapitalit. Është një tregues për të matë levën financiare, duke demonstruar shkallën në të cilën aktivitetet e një kompanie janë financuar nga fondet e kompanisë kundrejt fondeve të kreditorit. Caku: < 60%

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 54 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

2.4. Progresi me Planin e Biznesit

KOSTT sh.a, është Ndërmarrje Publike vepron si Operator i Sistemit, Transmetimit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës dhe zë një vend të rëndësishëm në sektorin e energjisë në Kosovë.

KOSTT drejtohet me ligjin korporativ të emërtuar si Ligji mbi Ndërmarrjet Publike.

Roli primar i KOSTT-it është që të operojë Sistemin e Transmetimit dhe Tregut të energjisë elektrike në Kosovë. Përgjegjësitë e KOSTT-it janë përcaktuar me ligjet e energjisë (Ligjin për Energji, Ligjin për Energjinë Elektrike dhe Ligjin për Rregullatorin e Energjisë) dhe në licenca. Po ashtu, përgjegjësi e KOSTT-it është edhe bashkëpunimi me operatorët e sistemit të Evropës Kontinentale në marrëveshjet rajonale dhe më gjerë.

Roli sekondar i KOSTT-it është që të operojë shërbimet e infrastrukturës së telekomunikacionit në të gjithë territorin e Kosovës. Në këtë drejtim, përgjegjësitë e KOSTT-it përcaktohen nga Ligji për telekomunikacion dhe Ligji për komunikime elektronike si dhe Autorizimi/Licenca e lëshuar nga ARKEP-i.

Misioni

Misioni i KOSTT-it është që:

- Të ofrojë shërbime cilësore duke implementuar teknikat dhe teknologjitë më të avancuara për zhvillimin e sistemit të transmetimit;
- Të sigurojë transparencë dhe jo diskriminim mes shfrytëzuesve të sistemit të transmetimit në një treg konkurrues të energjisë elektrike;
- Të promovojë qëndrimet e kompanisë në nivel rajonal dhe evropian;

Vizioni

“Të jetë kompani financiarisht e qëndrueshme dhe fitimprurëse, e cila siguron transmetimin e sigurt dhe të besueshëm të energjisë elektrike, e përgjegjshme në kuptim social dhe mjedisor dhe e integruar me rrjetet dhe institucionet evropiane të transmetimit të energjisë elektrike“.

Për të realizuar synimet e përcaktuara, janë vendosur edhe objektivat strategjike, të cilat para së gjithash kanë të bëjnë me sigurimin se KOSTT-i është një organizatë efektive, e aftë për të përballuar sfidat me të cilat do të përballlet në të ardhmen.

Objektivat e vendosura të KOSTT për vitin 2016 janë:

1. Planifikimi, zhvillimi dhe ndërtimi efektiv i sistemit transmetues të energjisë elektrike;

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 55 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

2. Avancimi i mirëmbajtjes dhe operimit të sistemit të transmetimit;
3. Siguria dhe besueshmëria e sistemit të transmetimit;
4. Krijimi i kushteve për operimin dhe zhvillimin e tregut të energjisë elektrike në pajtim me zhvillimet e pritura;
5. Qëndrueshmëria financiare;
6. Pjesëmarrja aktive në proceset e zhvillimit të tregut rajonal (të përfitojë nga zhvillimi rajonal dhe të kontribuojë në të);
7. Zhvillimi i tregut të përbashkët Kosovë – Shqipëri;
8. Anëtarësimin në ENTSO-E dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtarë;
9. Funkcionalizimi i zonës rregulluese/bllokut rregullues të KOSTT dhe implementimi i aranzhmaneve që ndërlidhen me operimin e sistemit dhe tregut në interkoneksion;
10. Vendosja e marrëdhënieve efektive me palët e interesit;
11. Të jetë punëdhënës atraktiv, që investon në zhvillimin profesional të punonjësve të vet;
12. Të jetë kompani e përgjegjshme në aspektin social dhe mjedisor;
13. Të krijojë një ambient të sigurt pune;
14. Optimizimi i punës së sistemit dhe eficienta.

Objektivat e lartcekura do të shërbejnë për analizimin e të arriturave të KOSTT gjatë vitit 2017, respektivisht, për implementimin e Plani të Biznesit për vitin referues.

Plani vjetor i mirëmbajtjes së linjave është realizuar 98%, i nënstacioneve 95% dhe i mbrojtjeve rele 100%. Aktivitetet kryesore të cilat janë përfshi në planin e mirëmbajtjes janë: kontrollimi i linjave dhe nënstacioneve, remontet e linjave dhe transformatorëve, shqyrtimi i rregullt transformatorëve dhe i fushave, termovizioni, shpërndarja e gazrave (DGA), shqyrtimet e mbrojtjeve rele, zëvendësimi i pjesëve dhe pajisjeve të domosdoshme në sistem, si dhe aktiviteteteve të planifikuara të mirëmbajtjes si pjesë e zhvillimit të projekteve dhe komisionimit të tyre.

Përveç kësaj janë zhvilluar edhe aktivitete tjera preventive si: realizimi i intervenimeve dhe evitimi i prishjeve, analizimi i prishjeve, Analiza e rënive dhe Operimeve, specifikimet teknike, pjesëmarrja në komisione të ndryshme për vlerësimin e ofertave, pjesëmarrja në komisione të ndryshme për pranim teknik, pjesëmarrja në implementimin e projekteve të ndryshme në Kostt etj.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 56 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

Të gjitha këto aktivitete kanë ndikuar në ngritjen e performancës së operimit të transmisionit. Kjo ka kërkuar një menaxhim dhe optimizim maksimal të ekipeve në teren.

Përveç kësaj janë zhvilluar edhe aktivitete tjera preventive, që kanë ndikuar në ngritjen e performancës së operimit të transmetimit. siç janë: kontrollimi vizual i stabilimenteve dhe operimi sipas kërkesave të QDN; realizimi i intervenimeve dhe evitimi i prishjeve; janë kryer specifikimet teknike për pjesë rezervë për mirëmbajtje, etj.

KOSTT do të vazhdojë edhe më ngritjen profesionale të stafit të mirëmbajtjes për teknologjinë e re në nënstacione dhe situatën e re të krijuar në linja, pas investimeve në linja të dyfishta si dhe kompletimin më tutje të pajisjeve të nevojshme.

Duke konsideruar perspektivën për angazhim në projekte të reja (biznese tjera jo të rregulluara), mundësia më e evidente për KOSTT-in tani është implementimi i komercializimit të shërbimeve nga lëmi i telekomunikacionit përkatësisht, paraqitja në treg e kapaciteteve tepriç të fijeve optike. Këto kapacitete telekomunikuese janë ndërtuar me qëllim të zhvillimit të sistemit të kontrollit dhe monitorimit të operimit të sistemit të transmisionit, andaj detyrë kryesore është (dhe do të jetë në të ardhmen): **Sigurimi i mbështetjes telekomunikuese për biznesin kryesor të KOSTT-it.**

Duke hyrë në tregun e telekomunikacionit të Kosovës, KOSTT-i do të:

- Zgjerohet në aktivitete të reja telekomunikuese, përveç aktiviteteve ekzistuese.
- Jetë më i përgatitur për të përballuar me sfidat e tregut të Kosovës: tani dhe në të ardhmen.
- Realizoj fitim shtesë.
- Arrijë një shkallë më të lartë të efektivitetit të biznesit të KOSTT-it.
- Mund të bashkëpunoj me operatorët fqinj të infrastrukturës së telekomunikacionit (në bazë të marrëveshjeve rajonale).
- Mbjajë një licencë të Operimit të Shërbimeve të Infrastrukturës së Telekomunikacionit.
- Kontribuoj në zhvillimin e TIK-ut në Kosovë.

Për të lehtësuar operacionalizimin e aktiviteteve të lartpërmendura, Banka Botërore ka ofruar një pako mbështetje teknike për KOSTT-in, në kuadër të një granti nga Ndërmarrja Këshilluese për Infrastrukturë Publike-Private (PPIAF) e cila shërbeu si bazë për fillimin e një biznesi të ri në Tregun e telekomunikimeve.

Në kuadër të këtyre përpjekjeve Telekom i KOSTT-it përpiloi **Rregulloren për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës alternative (pasive fibër optike)**, me anë të së cilës janë definuar kushtet e përgjithshme dhe janë dhënë udhëzime për ofrim në shfrytëzim të përbashkët të infrastrukturës alternative (pasive/fibër optike), me qëllim të:

- Minimizimit të ndikimit negativ në Operimin e Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës dhe të uljes së besueshmërisë, me ofrimin e infrastrukturës fibër optike;

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 57 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

- Përcaktimit të çmimit unik për qasje në infrastrukturën fibër optike dhe publikimit të tij në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese;
- Të lehtësimit të ofrimit të shërbimeve të infrastrukturës, procesit të negocimit dhe lidhjes së marrëveshjes/kontratës me palët kërkuese të shërbimeve të tilla.

Kjo Rregullore është aprovuar nga BD ne muajin Prill 2017 dhe si rezultat ne muajin Qershor është nënshkruar marrëveshja e parë për ofrim të shërbimeve të linjave me qira (fibra optik të pa ndriçuar) me tre operatore telekomunikues.

Në kontinuitet KOSTT Telekomit ka punuar në freskimin e **Planit të Biznesit për operimin e shërbimeve të infrastrukturës në tregun e telekomunikimeve**, me fokus kryesor të vlerësimit të mundësive të këtij biznesi.

Nga aspekti i sistemeve SCADA/RTU janë bërë një varg ndërhyrjesh në riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të sistemeve të SCADA-ve ekzistuese si ndërrimin e HMI-ve, monitorëve, BCU-ve, përfshirjen e të dhënave të reja në SCADA lokale në pajtim me llojet e pajisjeve primare të zëvendësuar. Është bërë edhe testimi periodik i funksionalitetit të Qendrës Emergjente Dispečerike, i cili ka rezultuar me sukses.

Janë bërë edhe shumë veprime të tjera të cilat kanë ndikuar në ngritjen e besueshmërisë së sistemit, të cilat janë dhënë në vijim:

- Korrigjimi i parametrave të rrjetit me qëllim të akordimit të State Estimatorit me SCADA/EMS dhe mundësimit të analizave kontingjente,
- Freskimi i topologjisë të rrjetit të observuar regional,
- Adaptimi i “Outage Schedule” për përcjelljen e shkyçjeve në formë elektronike;
- Rregullimi i infrastrukturës së domenit kostt-ost.com për shfrytëzimin e sigurt të “Advance Web” faqes së KOSTT-it;
- Ndërlidhja e harduerit për operim të tregut me platformën e RMC

Testimi i sistemit të shpërndarjes së AGC KOSTT – OST si dhe shtimi i shkëmbimit të të dhënave me QDNE2 të OST.

Pjesëmarrja në:

- shtimin e TR3 në NS Lipjani, Tr2 në NS Skenderaj dhe NS Burimi, Shtimi i Tr2 në NS Ferizaj 2,
- ndërrimi i sistemit kontrollues në NS Podujeva, NS Kosova B dhe NS Prishtina 5
- rehabilitimi i NS Peja1 me implementim të sistemit të ri te kontrollit –SCS,
- shtimi i elementeve të reja dhe rehabilitimi i ndërprerësve në NS Prishtina 4
- përfshirja e AC/DC të reja në SCS në NS 110/35/10 kV,
- përfshirja e anës 35kV te rehabilituar në SCS Ferizaj1 si dhe

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 58 nga 96</i>
<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>		

- fusha e anës sekondare të Transformatorëve të fuqisë në te gjitha nënstacionet 110/35/10 kV ;
- Konfigurimi, testimi dhe futja në funksion të Gateway-ave të ri në NS Vitia, NS Deçani, NS Gjilani1, NS Pishtina2, NS Prishtina3, NS Klina dhe NS Burimi dhe mundësimi i integritimeve të RTU-ve të rikonfiguruar në SCADA/EMS ne KCS dhe EKCS;
- Pjesëmarrja në SAT për projektet e realizuara, si në : Ns Lipjani, NS Podujeva, NS Prishtina 5, NS Kosova B, NS Prishtina 3,, dhe NS Peja 1;
- Revidimi i dizajneve të ndryshme teknike në kuadër të projekteve të implementuara, dërgimi i zgjidhjeve adekuate teknike dhe mbikëqyrja e implementimit të tyre si : NS Peja 1, NS Theranda, NS Skenderaj, NS Burimi, NS Drenasi 2, MS Mitrovica 2 dhe NS Prishtina 6;
- Mirëmbajtja e rregullt dhe preventive e të gjithë infrastrukturës monitoruese dhe të kontrollit të pajisjeve të SCADA/EMS, Telekomit, Matjeve dhe TI. Sigurimi i funksionalitetit të plotë i Qendrës Nacionale Dispeçerike Emergjente (rezervë) ;
- Funksionalizimi i plotë i qendrës për menaxhimin dhe monitorimin në kohë reale të infrastrukturës telekomunikuese NMS (Network Management System), kryesore në QND dhe asaj rezervë në QNDE, si dhe i radio sistemit telekomunikues;
- Testimi i LFC në mes të Kosovës dhe Shqipërisë;

Me ndihmën e inter-fejseve (ndërlidhjeve) TCP/IP dhe rrjeteve ethernet, është mundësuar integrimi HVM në rrjetet lokale të KOSTT, duke shmangur shfrytëzimin e rrjeteve të jashtme publike (GSM) dhe njëkohësisht duke zvogëluar koston e shfrytëzimit të tyre, Me ndihmën e inter-fejseve TCP/IP, rrjeteve ethernet dhe centralit telefonik IP, është mundësuar gjithashtu integrimi i të gjitha objekteve elektroenergjetike në rrjetin lokal telefonik të KOSTT – VOIP (Voice over IP), duke shmangur shfrytëzimin e rrjeteve të jashtme publike (PTK) dhe njëkohësisht duke zvogëluar koston e shfrytëzimit të tyre, Montimi dhe vërja në operim normal i RMC/backup të re.

Administrimi dhe Operimi në RMC (Remote Metering Center), llogaritja dhe analiza e humbjeve teknike në transmision.

Teknologjia e Informacionit luan një rol të rëndësishëm në përkrahjen e biznesit të kompanisë, duke filluar prej nevojave të komunikimit dhe informimit më të shpejtë, procesimin e shënimeve më të shpejta, ndihmës në zhvillim, ndihmës në rritjen e efikasitetit dhe efijencës, ndihma në proceset e kompanisë, zvogëlimin e shpenzimeve të biznesit, aplikimin e aplikacioneve të cilat mundësojnë zhvillimet e kompanisë pa të cilat këto zhvillime dhe procese nuk mund të imagjinohen.

Në këtë mënyrë, KOSTT ka arritur që të krijojë një infrastrukturë të mirë si nga ana harduerike, ashtu edhe ajo softuerike, gjegjësisht që përmes zhvillimit të aplikacioneve të

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 59 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

përkrahë dhe mundësojë zhvillimet e kompanisë dhe realizimin e objektivave të përcaktuara.

Është implementuar me sukses sistemi për arkivim automatik të email-ave përmes të cilit arrihet siguri e lartë dhe fleksibilitete jo vetëm e ruajtjes së email-ave por edhe gjurmëve të komunikimit me email për të gjithë stafin e KOSTT. Është bërë vazhdimi dhe instalimi i versionit të ri të licencave për NGFW (Next Generation Firewall) me çka arrihet nivel i lartë i sigurisë së sistemit të TI-së, si në aspektin e qasjes në sistem të TI nga jashtë, ashtu edhe në aspektin e ruajtjes dhe sigurisë së të dhënave të KOSTT, duke mundësuar monitorimin e komunikimeve, filtrimin e ueb faqeve, qasjen e sigurt të stafit të TI-së në sistem përmes VPN etj. Është bërë instalimi i versionit të ri të antivirusit, me çka arrihet siguri, besueshmëri dhe integritet i lartë i të dhënave dhe tërë sistemit të TI-së.

Po ashtu, është bërë migrimi i aplikacioneve të KOSTT Portalit në server të ri dhe versione të reja të Sistemit Operativ dhe MS (Microsoft) SQL Server-it².

Disponueshmëria e sistemit të TI gjatë vitit 2017 ka qenë 99.83% të kohës mesatare vjetore.

Investimet e realizuar në Rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2017 kanë ndikuar në arritjen e objektivave të KOSTT përmes rritjes së sigurisë në sistemit Elektroenergjetik.

Statusi i projekteve kapitale për vitin 2017:

1) Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në dhe Prizreni 3 Lot 2, financuar nga buxheti i KOSTT-it;

Gjatë Q3 2017 ka përfunduar afati garantues njëvjeçar;

2) Instalimi i transformatorit TR2 në NS 110/10 (20) kV – Skenderaj dhe NS Burim;

Implementimi i projektit ka përfunduar në Q2 2017 dhe tani është në afat garantues ;

3) Instalimi i transformatorit TR3 në NS 110/10 (20) kV – Prishtina 2

Statusi I projektit :Projekti ka përfunduar në Q1 2017 dhe ka përfunduar edhe afati garantues;

4) Instalimi i transformatorit TR2 në NS 110/10 (20) kV – Berivojcë dhe NS Viti

ka përfunduar afati garantues;

5) Revitalizimi i Nënstacioneve 110kV, ana 35kV (Gjilani 1 dhe Ferizaj 1)

- *Statusi i projekteve– projekti ka përfunduar dhe është në afat garantues*

6) Instalimi i Grupeve Matëse në kufirin në mes KOSTT/KEDS

² *Emërtim i serverëve për “data base system management”*

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 60 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

16. *Statusi i projektit: Projekti ka vazhduar me implementim në vitin 2017 dhe deri tani janë përfunduar në total 95% e punëve ,, kanë mbete të pa përfunduara punët instaluese në NS Vallaçi dhe NS Ujmani për shkak të situatës politike. Në NS Theranda punët instaluese janë shtyrë për vitin 2018 në ndërlidhshmëri me projektin e EBRD);*

7) Përfshirja e të gjitha ndryshimeve në nënstacionet ekzistuese si dhe inkorporimi i nënstacioneve të reja në SCADA/EMS në Qendrën Dispeçerike dhe në Qendrën Emergjente Dispeçerike

Statusi i projektit : Projekti ka përfunduar ;

- Përmirësimi i Rrjetit të Transmisionit faza IV &V" kontratë kjo që është e nënshkruar në Q1 2015 dhe është e ndarë në 4 LOT-e:

Statusi i projekteve: Projektet e përfunduar dhe në afat garantues

8) LOT 1: Nënstacionet

- *Ri-vitalizimi i NS Peja 1 (GIS) (*
- *Ndërrimi i ndërprerësve në NS Prishtina 4:*
- *Grupet Matëse në pikat interkonektive:*
- *Fushat transformatorike 400/110kV në NS Peja 3 dhe NS Ferizaj 2*

9) LOT 2 - Transformatorët Energjetikë

Instalimi i auto transformatorit të dytë ATR2, 300 MVA në NS Peja 3 dhe NS Ferizaj

10) LOT 3 - Linjat transmetuese

- *Linja e re e 110kV e dyfishte NS Peja 3 - NS Peja 1*
- *Revitalizimi I linjës 110kV L126/2 NS Peja 2- NS Decan*
- *Instalimi i OPGW në linjat interkonektive*

11) LOT 4 - Rehabilitimi i 19 nënstacioneve

- *Në NS VITI*
- *NS PR 4*
- *NS Lipjan*
- *Sistemi kontrollues në NS Kos B , NS Podujevë dhe NS Besian*
- *Shpenzimet vehtanake AC/DC në NS 110kV*
- *NS Peja 1 – furnizimi me pajisjet 10KV*

12) Shërbimet konsulente për Menaxhimin e implementimin Projektet e Zhvillimit të Transmisionit të Kosovë BERZH ;

Statusi i projektit:

13) LOT 1 – Nënstacionet [110/10(20) kV – NS Prishtina 6 dhe 110 kV HIS në NS Prishtina 4], [110/10(20) kV – NS Mitrovica 2], dhe [220/10(20) kV – NS Drenasi 2]

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 61 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

Projekti është në implementim, aprovimi i dizajneve dhe liferimi i pajisjeve 80% ndërsa punët implementuese nuk kanë filluar;

- 14) Ndërsa në [110/10(20) kV - NS Theranda] punët dizajnuese janë përfunduar 80% dhe ato implementuese 80%

Statusi i projektit: Në bazë të buxhetit të shpenzuar mund për ILOT1 në Total janë përfunduar 26% e punëve. Punët instaluese nuk kanë filluar për shkak të vonesave të shkaktuara në marrjen e lejeve ndërtimore;

- 15) LOT 2 - Transformatorët Energjetikë, (2x40 MVA në NS Prishtina 6, 2x40 MVA në NS Mitrovica 2 dhe 2x40 MVA në NS Drenasi 2);

Statusi i projektit: Në Qershor 2016 është nënshkruar kontrata dhe projekti është në fazën e dizajnit, inspektimit dhe prodhimit;

- 16) LOT 3 - Linjat dhe kabllo transmetuese [linja 110 kV e njëfishtë NS Rahoveci – NS Theranda], [linja 110 kV e dyfishtë dhe ajo kabllorike NS Fushe Kosova], [linja 220 kV e dyfishtë Drenasi 2], [linja 110 kV e dyfishtë NS Mitrovica2] dhe [linja 110 kV e dyfishtë kabllorike NS Prishtina 6 – NS PR 4]

Statusi i projektit: Në Qershor 2016 është nënshkruar kontrata dhe projekti është në fazën e dizajnit, inspektimit dhe prodhimit. Punët instaluese nuk kanë filluar për shkak të vonesave të shkaktuara në marrjen e lejeve ndërtimore; Në bazë të Buxhetit të shpenzuar për LOT 3 janë realizuar 37% e punëve.

KOSTT i kushton kujdes të veçantë sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve, sigurisë së aseteve dhe menaxhimit mjedisor duke përmbyshur: furnizimin me pajisje mbrojtëse; informimin dhe përkrahjen gjatë implementimit të dokumentacionit për zbatimin e procedurave për punë të sigurt gjatë mirëmbajtjes për linja, nënstacione dhe për kontraktues; inspektimin/monitorimin në teren të objekteve, aseteve, ekipeve të mirëmbajtjes dhe procesin gjatë realizimit të projekteve; largimin e materialeve të rrezikshme për shëndetin nga objektet ekzistuese; realizimin e matjeve të dëmtesve fiziko-kimik, kushteve mikroklimatike dhe intensitetit të fushave elektromagnetike në vendin e punës; angazhimin mbi zhvillimin e projektit për siguri dhe mjedis dhe sipas planit zhvillimor; zhvillimin dhe mirëmbajtjen e dokumentacionit për menaxhimin e sistemit të sigurisë dhe shëndeti në punë si dhe sistemin e menaxhimit të mjedisit konform rregullativës ligjore dhe kërkesave nga certifikimi me standardet ISO 14001 dhe OHSAS 18001; zhvillimi dhe mbajtja e programeve trajnuese për punëtorë; bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe lokale etj.

KOSTT edhe gjatë vitit 2017 si edhe deri më tani ka ofruar mbështetje për kryerjen e praktikës profesionale për studentë. Edhe këtë vit KOSTT dhe FIEK (Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike) kanë lidhur dhe implemnetuar një marrëveshje bashkëpunimi për implementimin e praktikës profesionale, veçanërisht për studentët e fakultetit të inxhinierisë elektrike duke iu ofruar mundësinë e punës praktike në KOSTT

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 62 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

në harmoni me programet adekuate, i cili bashkëpunim do të vazhdojë edhe më tutje. Po ashtu KOSTT-i ka lidhur dhe implemtuar një marrëveshje tjetër bashkëpunimi mbështetje për kryerjen e praktikës profesionale për studentë, me UBT (Universitetin e Biznesit dhe Teknologjisë).

Gjatë vitit 2017, KOSTT-i ka implemtuar dy projekte për implementimin e punës praktike në bazë të marrëveshjeve me:

1. “AECOM International Development” kompani e financuar nga USAID, për implementimin e punës praktike për inxhinierë të rinj – studentët e fakultetit të Inxhinierisë elektrike. Ky projekt është implemtuar dhe ka vazhduar nga vitet e kaluara deri tani në tri grupe. Grupi i dytë në përbërje prej gjashtë inxhinierëve-studentë ka vijuar deri në muajin prill. Ky projekt ka vazhduar edhe me grupin e tretë nga muaji tetor i vitit 2017 që do të vazhdojë deri në shkurt të vitit 2018.
2. MP&MS (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Agjencia e punësimit). Bazuar në këtë marrëveshje nga muaji nëntor 2017 janë angazhuar dhjetë praktikantë në KOSTT në projektin “Praktikant në KOSTT”. Këta praktikantë janë orientuar – përcaktuar në pozita ku është konsideruar e nevojshme angazhimi i tyre në harmoni me kualifikimin dhe përgatitjen shkollore.

Është investuar në zhvillimin profesional të punëtorëve me realizimin e trajnimeve, pjesëmarrjen në seminare, workshope dhe grupe punuese. Gjatë këtij viti ka pasur angazhim të punonjësve të KOSTT duke marrë pjesë në grupe punuese edhe pse pjesëmarrja e KOSTT-it në disa grupe punuese rajonale ende nuk është e barabarte me pjesëmarrësit e OST-ve tjera rajonale. KOSTT-i ka përkrahur vazhdimisht pjesëmarrjen në të gjitha grupet punuese me qëllim të informimit dhe aftësimin të stafit me të arriturat dhe zhvillimit rajonale e më gjerë.

KOSTT-i operon brenda një kornize rregullative të bazuar në ligje, licenca dhe në legjislacionin sekondar të miratuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRrE).

Të gjitha dokumentet, raportet e rregullta dhe të dhënat sipas sipas kërkesave të ZRRrE-së dhe të MZHE-së përgatiten dhe dërgohen në afatin e paraparë.

Nga perspektiva e Planit të Biznesit, aspekti më i rëndësishëm rregullativ është përcaktimi i të hyrave maksimale të lejuara dhe tarifave nga ana e ZRRrE-së. Në bazë të Rregullës për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të operatorit të sistemit të transmetimit dhe tregut (Rregulla për të Hyrat e OST/OT-së), KOSTT ka dorëzuar te ZRRrE propozimin për të Hyrat Maksimale të lejuara për vitin 2017, si dhe aplikacionin për tarifa që do të zbatohen gjatë vitit relevant tarifor.

Po ashtu, gjatë vitit 2017 nga ZRRrE është bërë iniciimi i procesit të dytë shumëvjeçar për të Hyrat e Lejuara Maksimale për periudhën rregullative 2018-2022. Sipas afateve të përcaktuara nga ZRRrE janë përgatitur dhe janë dorëzuar në ZRRrE dokumentet:

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 63 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

Aplikacioni për të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) me Formularët Raportues, të plotësuar me të dhënat ku janë paraqitur realizimet për periudhën 2013-2017 dhe me propozimet për HLM për periudhën e dytë shumëvjeçare 2018-2022, Plani pesë(5) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Transmetimit 2018 – 2022, dhe Plani pesë(5) Vjeçar Investues 2018 – 2022.

KOSTT sh.a si kompani publike dhe e rregulluar, vend të veçantë në veprimtarinë e përditshme i kushton transparencës, dialogut të hapur dhe konstruktiv me publikun si dhe përgjegjësisë ndaj aksionarit dhe palëve të tjera të interesit.

Gjatë vitit 2017 janë implementuar aktivitete në mbështetje të objektivave strategjike së kompanisë në përputhje me Strategjinë për Komunikim të cilat kanë pasur ndikim në përf forcimin e raporteve me palët e interesit, në informimin e drejtë të opinionit publik në lidhje me aktivitetet dhe veprimtarinë e KOSTT si dhe janë realizuar publikime në funksion të promovimit të zhvillimeve dhe të arriturave të KOSTT. Me qëllim të promovimit të identitetit të KOSTT është realizuar Plani i detajuar i Identitetit Vizuel Korporativ, projekt i cili do të zbatohet në vitin vijues.

KOSTT sh.a e konsideron Përgjegjësinë Shoqërore të Korporatave (CSR/PSK) si një proces përmes së cilës kontribuon në zhvillim të qëndrueshëm fillimisht përmes mënyrës se si operon duke inkorporuar politikat e biznesit të përgjegjshëm në politikat e brendshme të kompanisë dhe më tutje duke ndërmarrë aktivitete në shërbim të komunitetit si dhe duke dhënë kontributin në rrjetin e kompanive të përgjegjshme të Kosovës (Kosovo CSR Network), këtë vit në veçanti në hartimin e Planit Strategjik për CSR.

Gjithashtu, në mbështetje të fuqizimit të gruas në sektorin e energjisë, është dhënë kontribut në themelimin e Asociacionit të Gruas në Sektorin e Energjisë (AGSEK) dhe në draftimin e Statutit të organizatës. Asociacioni është themeluar me mbështetje të projektit të USAID-RePower.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 64 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

2.5. Realizimi i projekteve kryesore kapitale gjatë vitit 2017

Nr.	Emri i projektit	Buxheti	Financues	Vlera e kontratës	Kontrata shitesë	Data e fillimit	Data e përfundimit	Kontraktues	Buxheti i shpenzuar Gjatë vitit 2017
1	Instalimi i transformatorit TR2 në NS 110/10 (20) kV – Skenderaj – Burim	1,500,000.00€	KOSTT	1,538,601.28€ TOTALE: 1,679,626.12 €	141,024.85€-	15.05.2014	26.10.2015 (sipas annex kontratës dritë Q2 2017)	UKAB	59,693 .00€
2	Instalimi i transformatorit TR2 në NS 110/10(20) kV – Prishtina 2	1,500,000.€	KOSTT	1,092.230.48€	4,234.00€	12.09.2014	08.10.2015 (sipas aneks kontratës 22.07.2016)	MONTEN	68,270.25 €

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 65 nga 96</i>

Departamenti Financiar

Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:

3	Revitalizimi i nënstacioneve 110kV, ana 35kV (NS Gjakova 1, NS Gjilani 1 dhe NS Ferizaj 1)	400,000€	KOSTT	296.384.67€	-	29.02.2016	28.09.2016	KOMTEL	24,147.81€
4	Shërbime të Konsulencës për Projektin "Përmirësimi i Rrjetit të Transmetimit faza IV & V"	1,200,000.00 €	kfw/KE/KOSTT	1,178,240.00 € TOTAL 1,668,833.00	395,593.00 Adendum 1 € +95,000€ Adendum2	maj/2014	dhjetor/2017	MVV Decon/Consulectra	537,019.49 €
5	Përmirësimi i Rrjetit të Transmetimit faza IV & V LOT1: Nënstacionet	7.599.902,00 € Start dhe ECA 871,763.34€	IPA/kfw/KOSTT-Kredi	7.643.496,96 € +ECA 871,763.34€ TOTAL 8,515,160.34€ (pa TVSH dhe taksat doganore)	Ndryshimet në kontratë V0149,645.00€; V02(- 17,868.50€) dhe V03 (11,818.46€)	maj/2015	maj/2017	Siemens (At)	3,179,244.023 €
6	Përmirësimi i Rrjetit të Transmetimit faza IV & V LOT2: Transformatorët energjetikë	4,443,000.00 €.	IPA/Kfw (grant dhe kredi)	4,443,000.00 € (pa taksa doganore dhe TVSH)		mars/2015	maj/2017	Koncar (Hr)	1,942,300.00 €

7	Përmirësimi i Rrjetit të Transmetimit faza IV & V LOT 3: Linjat transmetuese	8,532,671.00€	IPA/kfW/KOSTT	8,199,403€ (pa TVSH dhe taxa doganore)	Ndryshimet në kontratë VO1 (- 333,267,25)€	27.05.2015	26.05.2017	Monte Dalekovod (Hr)	1,171,132.81€
8	Përmirësimi i Rrjetit të Transmetimit faza IV & V LOT 4: Rehabilitimi i 19 nënstacioneve me ECA garancion	8.722.018,00 € dhe ECA 1,062,728.34€	IPA/kfW/KOSTT-Kredi	8.857.944,68€ & ECA 1,062,728.34€ vlera Totale e projektit 9.920.673,02 € pa TVSH dhe taxa doganore	Ndryshimet n# kontratë V01(- 64,331.00€) dhe V02(198,964.28€), V03(1,293.40 €)	shtator/2015	dhjetor/2017	Siemens (At)	7,549,641.98€
9	Instalimi i grupeve matëse në kufirin në mes KOSTT/KEDS	2,500,000.00€	KOSTT	2,327,240.19€	-	24.11.2014	12.08.2016 deri më 01.10.2017	Monten & G3 Inxhinering	199,412.53 €
10	Shpronësimet dhe Servituta për projektet e KfW dhe LP 400kV	600,000.00 €	KOSTT	-	-	-	-	-	331,228.68 €

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 67 nga 96</i>

Departamenti Financiar

Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:

11	Taxa e Dogana për projektet e kFW	1,750,000€	KOSTT	-	-	-	-	-	792,327.09 €
11	Përfshirja e të gjitha ndryshimeve në nënstationet ekzistuese si dhe inkomporimi i nënstationeve të reja në SCADA/EMS në Qendrën Dispeçerike dhe në Qendrën Emergjente Dispeçerike	3,247,551.24	KOSTT					Alstom/KomtelPKoncar	1,184,001.40
12	Shërbimet të Konsulencës për implementim e projekteve të financuara nga EBRD “Projektet e zhvillimit të Transmetimit të Kosovës“	1,200,000.00€	BERZH/Kredi	1,071,988.25€	-	Q2 2016	Q2 2018	AF Consult Switzerland Ltd	420,225.64 €
13	Projektet me EBRD LOT 1 – nënstationet GIS No.45552	20,000,000.00€	BERZH (kredi)/KOSTT	19,614,980.67€		16.09.2016	15.09.2018	ABB (Italy/Croatia)	3,448,151.79 €

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 68 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

14	Projektet me EBRD LOT 2 – transformatorët e fuqisë	4,000,000.00€	BERZH (kredi)/KOSTT	3,880,401.28€		16.09.2016	15.09.2018	Hyundai/Balkan Petrol	00,00 €
15	Projektet me EBRD LOT 3 – Linjat transmetuese	7,663,246.33 €.	EBRD/KOSTT	7,663,246.00€	-	03.10.2016	02.10.2018	Romelectro	2,968,918.80 €

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 69 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

2.6. Perspektiva për vitin e ardhshëm

Ashtu si edhe deri më tani, përpjekjet e KOSTT-it, do të jenë të orientuara drejt realizimit të objektivave të saj strategjike (të cekura në pikën 2.4. të këtij Raporti), në përputhje të plotë me rolin, misionin dhe vizionin.

Në aspektin e operimit, përveç zhvillimeve që priten gjatë vitit 2018 (të cekura në pikën 1.6. të këtij raporti), do të implementohet edhe projekti i Kontrollit Frekuencë-Fuqi në bashkëpunim me OST-në e Shqipërisë, i cili në mënyrë kuptimplote mund ta ndryshojë regjimin e operimit të sistemit elektrik që mund të reflektojë në tri variante:

- Operimi si dy Bbloqe Rregulluese te veçanta me shkëmbim të shërbimeve ndihmëse
- Operimi me dy zona rregulluese të ndara në një Bllok rregullues me Shqipërinë, ose
- Operimi në një zonë të përbashkët në fazat e mëvonshme.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së përkohshme për kyçe KOSTT-ENTSO-E , pritet që KOSTT të fillojë operimin e pavarur të sistemit përfshirë këtu menaxhimin komercial të kongjestioneve në linjat interkonektive të Kosovës dhe alokimin e kapaciteteve interkonektive.

Modi ri i operimit përfshin kryesisht aktivitetet që ndërlidhen me bashkëpunimin e OST-ve të interkonektuara, me qëllim të operimit të sigurt të sistemit. Bashkëpunimi i ngushtë i OST-ve bazohet në parimet e respektimit të rregullave të ENTSO-E. Për të filluar operimin si bllok rregullues, në vitin 2018, në KOSTT duhet të arrihen këto objektiva :

- Ngritja e kapacitetit të stafit të Operatorit të Sistemit dhe Operatorit të Tregut për të performuar me punët e reja që ndërlidhen me operimin e KOSTT si bllok rregullues dhe implementimin e marrëveshjeve operative me ENTSO-E dhe OST-të fqinje, në veçanti me:
 - analizën e sigurisë së punës së sistemit një ditë para dhe gjatë ditës;
 - nominimin e programit ndërkufitar dhe programeve të palëve tregtare një ditë para në formë të automatizuar përmes softuerëve adekuatë;
 - krijimin e modelit referent të rrjetit për SEE të Kosovës për qëllim të llogaritjeve të parametrave të sigurisë së operimit, veprimi adekuat në rrethana emergjente, përpunimi i planit të ri mbrojtës, alokimin e kapacitetit dhe llogaritja e kongjestioneve.

Aktivitetet e mësipërme KOSTT do t'i bashkërendis me konsulencën CBA- konzorciumin “Eliagrid”, e financuar nga EBRD. Ky projekt quhet “Capacity Building Assistance”, dhe ka filluar më 24 prill 2016, ndërsa përfundon më 15 gusht 2018.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 70 nga 96</i>
<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>		

- Investimet në zhvillimin e infrastrukturës që mundësojnë proceset e mësipërme, që janë:
 - Qasja në “electronic highway –EH”
 - Implementimi dhe operimi i Sistemit të TI të Tregut për të bërë në mënyrë automatike procesimin dhe shkëmbimin e të dhënave me OST-të tjera sipas kërkesave të ENSTO-E;
 - Dërgimi i të dhënave në kohë reale në Qendrën Koordinative të Evropës Kontinentale-Swissgrid, të specifikuar nga PG TSO KOSTT;
 - Dërgimi i të dhënave dhe monitorimi i një pjese të sistemit transmetues për çështje të sigurisë së operimit të sistemit në KOSTT dhe të sistemeve tjera: OST, MEPSO, CGES dhe EMS sipas kërkesave të ENTSO-E;
 - Shkëmbimi i të dhënave me OST-të tjera për qëllim të nominimit të programit dhe barazimit përfundimtar duke përfshirë edhe themelimin e Iniciativës Rajonale për Siguri të Koordinuar, RSCI;
 - Shkëmbimi i të dhënave në fazën planifikuese me OST tjera përmes platformës softuerike SMTA, CGM\OPDE,OPC
 - Shkëmbimi i të dhënave në kohë reale me TSO Evropiane përmes platformës softuerike EAS
 - Shkëmbimi i të dhënave me Bllloqet Rregulluese fqinje dhe Qendrën Koordinative;
 - Marrëveshjet për alokimin e kapaciteteve në baza vjetore, mujore, ditore me OST-të fqinje.

ENSTO-E ka krijuar grupin prej ekspertëve për monitorimin e KOSTT-it në plotësimin e kërkesave nga manuali i operimit(PG TSO KOSTT). Kërkesat janë kryesisht teknike, që ndërlidhen me sigurinë e operimit të sistemit, shkëmbimet tregtare ndërkufitare dhe plotësimi i kriterëve nga paketi i tretë i energjisë të KE.

Objektivat e monitorimit nga ENTSO-E janë:

- Siguria e operimit të sistemit elektroenergjetik nga aspekti i rrjetit;
- Siguria e Shërbimeve ndihmëse;
- Ndryshimet e nevojshme rregullative që kërkohet nga paketi i tretë i legjislacionit të Komisionit Evropian për Energji

Duke i përcjellë zhvillimet e reja në sektorin e energjisë respektivisht, procesin e integritimeve evropiane, KOSTT duhet të ndjekë rrugën e plotësimit të kërkesave dhe standardeve që rrjedhin nga këto procese. Plotësimi i standardeve gjithashtu është kërkesë e procesit të zhvillimit të projekteve voluminoze në KOSTT.

Një nga objektivat strategjike të KOSTT është edhe përkujdesi për shëndetin e punëtorëve, i cili është realizuar me projektin e sigurimit shëndetësor suplementar për të

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 71 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

gjithë punëtorët edhe gjatë vitit 2017 meqenëse Ligji për sigurimet shëndetësor ende nuk është implementuar. Kjo ka ndikuar në mbajtjen e shëndetit të mirë të punëtorëve, në motivimin e punëtorëve për punë dhe arritjen e objektivës për të qenë punëdhënës atraktiv si dhe në ngritjen e kualitetit të punës dhe performancës së kompanisë në përgjithësi.

Në kuadër të kujdesit shëndetësor si kërkesë obligative ligjore me qëllim të përcjelljes permanente të gjendjes shëndetësore të punëtorëve, hyjnë edhe kontrollet sistematike mjekësore, të cilat janë realizuar nga shumica e punëtorëve e sidomos atyre në vendet e punës në kushte specifike të punës.

Në të ardhmen pas implementimit të Ligjit për sigurimet shëndetësore mendohet që të shkohet edhe me projekte tjera për mbrojtjen e punëtorëve në aspektin e shëndetit duke u bazuar në sigurimet tjera si në rast të aksidenteve personale për pjesën e punëtorëve të cilët punojnë në kushte të veçanta të punës.

Ashtu si edhe vitet e mëparshme, me qëllim të arritjes së objektivave të saj KOSTT ka punuar në krijimin e kushteve sa më të mira të punës për të gjithë punëtorët e sa si në rregullimin e hapësirave të punës ashtu edhe në krijimin e kushteve tjera më të mira për punë. Për këtë qëllim është realizuar Projekti i renovimit të zyrave në Kurriz, paraprakisht të rikthyera në pronësi të KOSTT-it, në sipërfaqe shfrytëzuese prej 240m². Gjithashtu janë realizuar shumë projekte të cilat do të mundësojnë një vend pune në të cilën punëtorët do të ndihen më mirë në realizimin e detyrave të tyre si dhe arritjen e një performace më të mirë. Duke pasur parasysh këtë, investimet janë bërë duke filluar prej rregullimit të zyrave dhe ambientit tjetër të punës në NS PE2 dhe NS Kosova B me kujdes të veçantë në Eficiencën e energjisë – duke përdorur materiale termike, ndriçimit eficient, etj. dhe duke krijuar kushtet më të mira për të gjithë punëtorët e saj, në harmoni me standardet më të larta.

Me qëllim të integritetit të ngrohjes dhe ftohjes në Ndërtesë afariste, në sistemin qendror me ujë nga Stacioni Termik dhe me qëllim të unifikimit të sistemit në tërësi është realizuar Projekti i ngrohjes në katin e Dispeçerëve i cili është ndërlidhur me sistemin e ngrohjes së qytetit me avantazhe e veta si në aspektin e eficiencës së shfrytëzimit të energjisë ashtu edhe në koston e mirëmbajtjes.

Gjithashtu është realizuar edhe Projekti i rrethojës, ndriçimit dhe mbrojtjes perimetrike të NS Prishtina 3.

Siguria fizike në KOSTT, e cila nënkupton mbrojtjen e të gjitha asetëve të kompanisë KOSTT nga kërcënimet me vjedhje apo dëmtime, gjatë vitit 2017 ka pasë ngritje të performacës, dhe nuk është evidentuar asnjë rast i cili në çfarëdo mënyre do të mund të cenonte apo përbënte rrezik për asetet vitale të KOSTT-it, të cilat do të mund të ndikonin në vazhdimësinë e punës.

Gjatë vitit 2017 në sektorin e Administratës janë bërë ndryshime sidomos në sistemin elektronik të Arkivit i cili ka pësuar ndryshime drejt funksionalitetit dhe efikasitetit më të punës duke mundësuar shfrytëzimin e sistemit edhe nga ana e Menaxhmentit. Këto ndryshime janë bërë në harmoni me ndryshimet e dispozitave ligjore sidomos për formën

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 72 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

e ruajtjes dhe klasifikimit të dokumenteve zyrtare Në vitin 2018 do të pasojnë ndryshime në procedurat dhe politikat të cilat ndërlidhen me afatin ligjor të ruajtjes dhe shkatërrimit të dokumenteve në kompani të cilat gjithashtu do të jenë në harmoni me ligjin.

Do të bëhen edhe renovimet e nevojshme të hapësirave për ruajtjen e dokumenteve të cilat do të jenë sipas standardeve më të mira.

KOSTT edhe më tutje do të vazhdojë me punën e suksesshme për krijimin e një ambienti për investimin në zhvillimin profesional të punëtorëve dhe motivimin e tyre në arritjen e performancës së standardeve më të larta. Kjo bëhet duke investuar në trajnimet profesionale të financuara nga buxheti i KOSTT për trajnime ashtu edhe përmes trajnimit në kuadër të projekteve përkatëse të cilat janë duke u implementuar. Gjithashtu përveç trajnimeve zhvillimi bëhet edhe përmes formave tjera duke e përfshirë pjesëmarrjen në FAT, literaturën profesionale si dhe shfrytëzimit të bazës së njohurive e cila është krijuar në kompani. Kjo është po ashtu në përputhje me objektiven strategjike - që të jetë punëdhënësi atraktiv.

Me qëllim të azhurnimit dhe harmonizimit të plotë të kërkesave gjatë vitit 2017, KOSTT ka implemnetuar me përpikëri të gjitha kërkesat e standardit ISO 9001 duke kaluar nga versioni ISO 9001:2008 ne versionin e ri ISO 9001:2015.

Gjatë vitit 2017 ka filluar implementimi i plotë i kërkesave ISO 9001:2015 dike pasur përmirësim të vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të cilësisë.

Në kuadër të Menaxhimit të cilësisë KOSTT, ka zhvilluar edhe dy standardet e reja: Standardi për sigurinë e punëtorëve ISO 18001 dhe standardi për siguri të ambientit ISO 14001. Njëkohësisht, KOSTT ka zhvilluar duke bere integrimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe ndërtimin e një “sistemi të integruar të menaxhimit të cilësisë” duke krijuar mundësinë e plotësimit/integrimit edhe të standardeve për siguri të informacionit 27001 dhe 27002; IEC standardeve/standardeve për pajisje energjetike; standardin për menaxhimin e aseteve energjetike ISO 5500.

Në tendence të zhvillimi të vazhdueshme dhe të qëndrueshëm të sistemit të menaxhimit të cilësisë, KOSTT i është nënshtruar një auditimi të jashtëm të kontrollit të cilësisë i cili ka rezultuar me certifikimin e kompanisë me tri certifikata për cilësi sipas standardeve ISO 9001:2015; ISO 14001:2015 dhe OHSAS 18001:2007.

Parimet themelore të lidhura me udhëheqjen e mjedisit përfshijnë rinjohjen e aspekteve dhe ndikimeve në mjedis në bazë të cilave parashtrohen synimet dhe programet, përcillen rezultatet e matshme të zbatimit të tyre, andaj në mënyrë periodike ndërmerren aktivitetet për përmirësim permanent.

Përmes procesit të certifikimit të sistemit të udhëheqjes me mjedisin dhe sigurinë, priten efekte pozitive, siç janë: përmirësimet e gjendjes në perimetrin mjedisor dhe të sigurisë vetanake, investimet më racionale në projektet e mbrojtjes së mjedisit dhe sigurisë, si dhe

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 73 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

shumë efekte tjera të ngjashme. Nga ana tjetër, synohet një avancim në raport me institucionet kompetente, duke bërë ngritjen e përgjegjësisë dhe vetëdijes mbi mbrojtjen e mjedisit dhe të sigurisë në tërësi, si dhe duke përmirësuar pasqyrën afariste ndaj publikut të gjerë, gjë që i kontribuon përmbushjes së synimeve themelore afariste të KOSTT-it.

Me këtë qasje KOSTT-i si ndërmarrje publike bëhet anëtar i përhershëm, i vetëdijshëm dhe i përgjegjshëm i mjedisit në të cilin vepron si dhe përmes sistemit që aplikon, me qëllim që ta përparojë cilësinë e jetës në mjedisin e drejtpërdrejtë, si dhe atë në nivelin global.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 74 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

2. 7. Rreziqet

Në afarizmin e KOSTT, kanë ndikim edhe rreziqet e mundshme, si pasojë e ndikimeve që vijnë nga jashtë, respektivisht nga rrethina afariste, dhe si të tilla, kanë implikimet e tyre në veprimtarinë e KOSTT.

Në vazhdim janë analizuar dhe identifikuar disa nga këto rreziqe:

- Pamundësia e fillimit të operimit të KOSTT-it si zonë/bllok rregullues përkatesisht implementimit të marrëveshjes se kyçjes KOSTT- ENTSO-E për shkak të obstrukcioneve nga Serbia. Për pasojë, nuk menaxhohen kongestionet në linjat interkonektive dhe te hyrat nga alokimi i kapaciteteve nga KOSTT, dhe kështu vazhdon bllokimi i KOSTT-it në integrim, respektivisht në zhvillim dhe hapje të tregut
- Pamundësia e fillimit të operimit të KOSTT si zonë rregulluese do të pengoj KOSTT dhe Kosovën në përmbushjen e zotimeve të 6 shteteve të Ballkanit, e njohur si iniciativa e WB6 për themelimin e tregut të organizuar (spot market), tregut rajonal balancues dhe alokimit rajonal të kapaciteteve interkonektive.
- Te hyrat nga alokimi i kapaciteteve përkatesisht menagjimi i kongestionëve sipas rregullave destinohet ne zhvillimin e rrjetës interkonektive per zvogëlimin e kongestionëve. KOSTT ka investuar ne linjën 400kV Kosove-Shqiperi dhe ka filluar kthimin e kredisë. Kthimi i kredisë behet nga te hyrat 100% nga tarifa e konsumatoreve ne Kosove. Derisa nuk fillon operimi zone rregullues KOSTT nuk do te jete ne gjendje mbledhjen e te hyrave nga alokimi i kapaciteteve
- Veshitëresite e mundshme financiare nga mos inkasimi i të hyrave;
- risku rregullator në miratimin e tarifave që nuk reflektojnë koston reale;
- efiçienca prej 4% e kërkuar nga ZRRë, që për KOSTT është e pamundur të arrihet
- gjendja e aseteve të transferuara nga KEK-u gjithashtu paraqesin kërcënim në zvogëlimin e performancës së furnizimit dhe kostot shtese te zhvillimit
- kriza globale;
- pamundësia e operimit, mirëmbajtjes dhe zhvillimit të një pjese të rrjetit transmetues të Kosovës, për shkak të qasjes së kufizuar në pjesën veriore të vendit, si dhe ndërhyrjes ilegale të Operatorëve serb EMS dhe EPS.

Në mënyrë që të ulet ndikimi në secilin rrezik, janë të domosdoshme këto veprime:

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 75 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

- Vazhdimi i aktiviteteve rreth evitimit të pengesave nga EMS dhe implementimi i marrëveshjes së kyçjes KOSTT-ENTSOE. Anëtarësimi sa më shpejt që është i mundur
- Avancimi i operimit të sistemit të transmetimit që i paraprinë me aftësinë e sistemit elektroenergjetik të akomodojë kërkesat e shfrytëzuesve të sistemit, duke ofruar shërbime të kualitetit të lartë, posaçërisht ndaj investitorëve privatë të gjenerimit dhe furnizimit dhe shpërndarjes;
- Bashkëpunimi intensiv me palët e interesit duke sqaruar avantazhet e tregut të energjisë elektrike;
- Analiza e mundësisë që KOSTT dhe Kosova të jenë pjesë e APE (Albanian Power Exchange), që është duke u zhvilluar në Shqipëri në kuadër të iniciativës WB6.
- Implementimi eficient i investimeve kapitale të KOSTT-it

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 76 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

Aneks

1. Sponzorimet dhe donacionet

Gjatë vitit 2017 KOSTT ka ndarë 2,000 € për KAEF-in. (Fondi Kosovar – Amerikan për Arësim), 1,950.00 € për Klubin Hendbollistik të Femrave “Prishtina”, 1,500.00 € në emër të përkrahjes financiare të Akcionit për Nënata dhe Fëmijët, 1,500.00 € për Kujdesin ndaj Fëmijëve të Kosovës dhe 2,000.00 € për Shoqatën Elektroteknike të Kosovës- CIGRE Komiteti Nacional Kosovë.

Në total. Mbështetja e ofruar financiare ka vlerën totale prej 8,950.00 €.

2. Raporti i auditorit të brendshëm

Raporti përfshinë rezultatet e aktiviteteve audituese të kryera gjatë vitit 2017. Këto aktivitete janë kryer sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike, manualit për auditim të brendshëm, procedurave dhe standardeve të cilat janë në funksion të auditimit të brendshëm, me qëllim garantimin e një efëçencë sa më të lartë në funksion të optimizimit të vlerës në Ndërmarrje.

Për vitin 2017, është përgatitur plani i auditimit të brendshëm dhe është prezantuar para Komisionit të Auditimit, i cili është aprovuar në përputhshmëri të plotë me standardet e auditimit.

Aktivitetet e auditimit janë zhvilluar sipas planit strategjik dhe vjetor të auditimit, në përputhje me objektivat dhe natyrën e njësisë audituese.

Në raportet e auditimit janë prezantuar aktivitetet, objektivat, të gjeturat, konkluzionet dhe rekomandimet.

Çdo aktivitet në kuadër të Ndërmarrjes Publike, të cilat ekzistojnë në kuadër të sistemit për menaxhimin e kontrollit dhe të cilësisë dhe të cilat janë në funksion të ligjeve, procedurave dhe rregullave përkatëse, duhet që ti nënshtrohen në mënyrë sistematike procedurave të auditimit të brendshëm.

Pjesë e rëndësishme e procesit për menaxhimin e funksionimit të auditimit është planifikimi i përdorur sipas këtyre kriterëve:

- **Objekti i auditimit** – duhet të disponojë dëshmi të mjaftueshme dhe adekuate për të shprehur konkluzione dhe rekomandime efikase.
- **Metodologjia e auditimit** – Përcaktimi i proceseve dhe procedurave që duhet të auditohen.
- **Vlerësimi i rrezikshmërisë** – matet nga devijimet (shmangiet) e ligjeve dhe procedurave.
- **Përcaktimi i prioriteteve audituese** – në bazë të:

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 77 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

- Ndikimit financiar dhe material;
- Rasteve urgjente me rrezikshmëri të lartë;
- Ndërlíkueshmërisë në proceset audituese;
- Kohëzgjatja e fushës së auditimit;
- Rëndësia për imazhin afarist të kompanisë dhe
- Faktorët e brendshëm të cilët kërkojnë ekzaminim për çështjet e caktuara.

Misioni dhe Vizioni

Të ndihmohet ndërmarrja që të mbajë lart përgjegjshmërinë e menaxhimit gjatë përdorimit të parasë publike.

Të ipet vlerësimi mbi formën e përdorimit të fondeve me ekonomicitet, efektivitet dhe eficiency, duke kontribuar për qeverisje më të mirë nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.

Vizioni:

Rritja e rëndësisë së auditimit duke i kthyer rreziqet në rezultate.

Aspiratat, qëllimet që duhet arritur dhe objektivat që duhet përmbushur në të ardhmen, duke dhënë siguri të arsyeshme mbi llogaritë financiare dhe duke ndihmuar në përmirësimin e menaxhimit të parasë publike.

Qëllimi Strategjik

Qëllimi strategjik është që të realizojmë vlerësimin e eficiency së menaxhimit të Ndërmarrjes, duke kontribuar në shtimin e vlerës së tyre dhe forcimin e sistemit të kontrollit mbi to.

Për këtë qëllim ne shohim nga e ardhmja, duke synuar që të aplikojmë metodologjinë dhe teknikat më të mira bashkëkohore, duke i rritur resurset njerëzore dhe teknike që ndikojnë në zgjerimin e aktiviteteve për arritjen e objektivave;

Ngritja edhe më tepër e imazhit të këtij shërbimi krijon një siguri ku aktiviteti i kësaj është mbrojtja e interesit të Ndërmarrjes.

Çfarë ne duam:

Zyrtari i Auditimit të Brendshëm si përgjegjës për kryerjen e auditimit financiar, pajtueshmërisë së sistemeve, performancës, këshillimit, etj, në përputhje me rregullat në fuqi të cilat i përkasin fushës së auditimit të brendshëm dhe praktikave më të mira në këtë fushë, jep vlerësim të pavarur mbi veprimtaritë e audituara dhe identifikon nëse ato janë zhvilluar sipas rregullave në fuqi, nëse paratë e qytetarëve të vendit janë shpenzuar me eficiency, efektivitet dhe ekonomicitet, **si dhe në pajtim me ligjet përkatëse.**

Prioritetet kyçe

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 78 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

Prioritetet kryesore strategjike i referohen rritjes së efijencës së burimeve të auditimit të orientuar nga analiza periodike e marrëdhënies, **burimet e përdorura = rezultatet konkrete** (niveli i performancës).

Për këtë, janë përcaktuar katër prioritetet kryesore si në vijim:

- Ngritjen e procesit për vlerësimin e rrezikut;
- Zgjerimin e mundësive për të monitoruar rreziqet emergjente;
- Vënia edhe më tepër në funksion të impaktit konkret në arritjen e objektivave të Ndërmarrjes;
- Duke u munduar në uljen e kostove dhe duke e ngritur nivelin e performancës.

Aktivitetet e planifikuara për vitin 2017 - Zbatimi i planit vjetor


Gjatë vitit 2017, plani i auditimit është realizuar në tërësi.

Sipas planprogramit janë paraparë të kryhen pesë auditime të departamenteve dhe zyrave, ku në kuadër të këtyre departamenteve janë audituar edhe njësitë përkatëse.

Përzgjedhja e njësive audituese

Departamentet e audituara, janë përzgjedhur në bazë të nivelit të përgjegjësisë, kompleksitetit, riskut, natyrës së vëllimit të aktiviteteve, për të cilat Menaxhmenti Ekzekutiv duhet të veprojë në mbështetje të plotë për implementimin apo zvogëlimin e rekomandimeve.

Statuti i auditimeve në fund të vitit 2017




Burimet e auditimit janë menaxhuar me efijencë dhe në funksion të realizimit të planit vjetor.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 79 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

Treguesit e përfomancës së auditimit për vitet 2014 deri 2017

Nga analiza e treguesve të përfomancës së auditimeve, veçanërisht të atyre më specifike, rezulton se ndër vite kemi ndryshime të rekomandimeve. Numri i rekomandimeve ka një lëvizje të rritjes nga 40 rekomandime në vitin 2014 në 61 rekomandime në vitin 2015 dhe një rritje nga 59 rekomandime në vitin 2016 në 65 rekomandime në vitin 2017.

Treguesit e rekomandimeve / auditimeve, për periudhën 2014-2017



Rekomandimet e dhëna duke u bazuar në natyrën e gjetjeve ekzistojnë për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, evitimin e parregullsive, parandalimin e shpërdorimeve, ruajtjen e pasurisë publike, etj.

Gjatë auditimit i kemi ekzaminuar dhe testuar çështjet me ndikim më të lartë, ku në vazhdimësi të procesit të auditimit janë dhënë rekomandimet të cilat janë prezantuar në raportet e auditimit. Janë dhënë edhe këshilla gojore të ndryshme varësisht nga natyra dhe kërkesa e personelit.

Departamentet/Zyrat e audituara dhe numri i rekomandimeve

Nr.	Departamentet	Rekomandimet për vitin 2017
-----	---------------	-----------------------------

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 80 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>


1.	Departamenti i Operimit të Transmisionit	27
	Departamenti për Çështje Ligjore dhe Rregullative	6
3.	Departamenti i Burimeve Njerëzore	11
	Departamenti i Financave	6
5.	Departamenti i Prokurimit	15
	Totali	65

Raportet paraqesin nivel kyç për adresimin e këshillave në ngritjen e nivelit të përmirësimit për dobësitë, gabimet apo paqartësitë të cilat ekzistojnë në Ndërmarrje. Në përgjithësi auditimet kanë reflektuar pozitivisht në ngritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të ndërmarrjes.

Në përgjithësi subjektet e audituara kanë treguar progres në përmirësimin e sistemit të mjedisit të kontrollit, zbatimin e procedurave, ligjeve dhe rregullave përkatëse. Gjithashtu kanë treguar një bashkëpunim të mirë, duke e marrë për bazë këshillat dhe rekomandimet të cilat do të jenë gjithmonë në funksion të optimizimit të vlerës në Ndërmarrje.

Raportimi i të gjeturave në kohë dhe cilësi është një mbështetje për Ndërmarrjen që të sigurojë llogaridhënie në cilësinë e menaxhimit dhe funksionimit të saj.

Treguesit e rekomandimeve për Vitin 2017 sipas departamenteve



Gjatë vitit auditues 2017, departamentet / njësitë audituese i kanë përgatitur planet për veprim për implementimin e rekomandimeve dhe janë aplikuar testimet matëse për shkallën e zbatueshmërisë së implementimit të tyre.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 81 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

Niveli i implementimit të rekomandimeve

Një nga sfidat e konsideruara është vlerësimi mbi implementimin e rekomandimeve. Ky fakt e rritë cilësinë e tyre dhe e forcon bashkëpunimin me njësitë e audituara, që ato të ndërmarin veprime të konsiderueshme në implementimin e gjetjeve në lidhje me gabimet e ndodhura dhe përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Këtë e bënë duke u përpjekur që:

- T'i implementojë rekomandimet dhe të rrisë dobinë e tyre për njësitë e audituara;
- Të rrisë bashkëpunimin me njësitë e audituara, me synimin e rënies dakord që ato të implementohen;
- Të kërkoj respektimin e afatit për veprimet e marra ndaj njësisë nga menaxhmenti për implementimin e rekomandimeve;
- Të kërkohet përgjegjësi ndaj personave përgjegjës për mos implementimin e rekomandimeve.

Në muajt e fundit të vitit 2017, kemi aplikuar testime matëse në njësitë përkatëse të audituara për të parë nivelin e implementimit të rekomandimeve dhe për tu siguruar se njësitë kanë ndërmarrë veprime konkrete korrigjuese në implementimin e rekomandimeve, po ashtu janë marrë konfirmimet përkatëse nga këto departamente se në çfarë niveli janë duke u implementuar rekomandimet.

Të gjitha rekomandimet e prezantuara i përkasin natyrës për forcimin e kontrollit të brendshëm, nivelin e përgjegjësisë, eliminimin e gabimeve apo paqartësive në funksion të përmirësimit të sistemit. Në bazë të kësaj, konstatohet se ka avancime pozitive në implementimin e rekomandimeve.

Gjendja e implementimit të rekomandimeve në fund të Vitit 2017

Nr.	Departamentet	Plani për implementim	Implementim i tërësishëm	Implementimi në Proces	Nuk janë implementuar, vijojnë në 2018
1.	Departamenti i Operimit të Transmisionit	I përgatitur	60 %	20 %	20 %
2.	Departamenti për Çështje Ligjore dhe Rregullative	I përgatitur	80 %	10 %	10 %
3.	Departamenti i Burimeve Njerëzore	I përgatitur	70 %	15 %	15 %
4.	Departamenti i Financave	I përgatitur	80 %	10 %	10 %

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 82 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

5.	Departamenti i Prokurimit	I përgatitur	70 %	20 %	10 %
-----------	---------------------------	--------------	------	------	------

Cilësia e raportimit të auditimit

Përqendrimi kryesor është bërë në respektimin e standardeve të raportimit për auditim të brendshëm, me qëllim hartimin e raporteve të besueshme, koncize, të sakta, të bazuara në fakte dhe mbi të gjitha, të vlefshme për ta ndihmuar menaxhmentin në përmirësimin e punës dhe rritjen e efikasitetit të aktiviteteve në Ndërmarrje.

Rritja e cilësisë së raportimit, do të vijojë të jetë prioritet dhe nën monitorimin sistematik.

Raportet janë hartuar sipas Manualit të Auditimit të Brendshëm, si dhe programeve dhe udhërrëfyesve tjerë specifik. Janë respektuar standardet në fushën e raportimit për sa i përket përmbajtjes, kohës, cilësisë, qartësisë dhe dobishmërisë së kësaj faze të procesit auditees.

3. Raportimet sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike

3.1. Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet gjatë vitit 2017

Gjatë muajit maj të vitit 2017, në makro skemën organizative të KOSTT-it janë bërë disa ndryshime, që kanë të bëjnë me ndryshime në zyrën e Kryeshefit Ekzekutiv duke i miratuar dy pozita për Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv për Operim dhe Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv për Zhvillim.

Ndryshime janë reflektuara në Sektorë dhe atë në Departamentit të Burimeve Njerëzore, Departamentin e Operatorit të Sistemit, dhe në Departamentin për Çështje Ligjore dhe Rregullative. Ndryshimet në harmoni me kërkesat e reja janë implementuar nga 01.06.2017 dhe shihen në Makro Skemën Organizative të KOSTT.

Struktura e menaxhmentit më të lartë të KOSTT-it përbëhet nga pozitat vijuese: Kryeshefi Ekzekutiv (KE), Zëvendës Kryeshefi Ekzekutiv për Operim, Zëvendës Kryeshefi Ekzekutiv për Zhvillim; Sekretari i Kompanisë; Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit, Auditori i Brendshëm dhe nga Drejtorët e departamenteve vijuese:

- Operatori i Sistemit;
- Operatori i Transmetimit;
- Operatori i Tregut;
- Inxhinieringu dhe Menaxhimi i Projekteve;
- Çështjet Ligjore dhe Rregullative;

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
<i>ver. 1.1</i>		<i>faqe 83 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

- Financat;
- Burimet Njerëzore;
- Prokurimi;
- Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv, që mbulon Zyrën për Zhvillimin dhe Planifikimin Afatgjatë, Zyrën për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun dhe Zyrën për Sigurinë Industriale dhe Mjedisin.

Në fazën pasuese të riorganizimit, nevojitet të merren parasysh aktivitetet e shtuara të KOSTT Telekomit, konkretisht në kontekst të komercializimit të infrastrukturës fibër optike, , si rrjedhojë e obligimeve të shtuara për operimin e infrastrukturës telekomunikuese fibër optike në kuadër të tregut të shërbimeve telekomunikuese, të përshkruara në licencën e lëshuar nga ARKEP-i.

Ekzistojnë një sërë çështjesh që do të kenë ndikim në organizimin e KOSTT-it, si:


- Zhvillimi i sistemit të Transmetimit nga këndvështrimi i kapaciteteve të rrjetit dhe kontrollimit të tij;
- Nevoja për të arritur nivel më të lartë efikasiteti brenda kompanisë;
- Nevoja si rrjedhojë e integriteteve në institucionet ndërkombëtare Evropiane dhe rajonale, si dhe ndryshimeve dhe zhvillimeve në tregun e energjisë elektrike.
- Nevoja si rrjedhojë e hyrjes së KOSTT-it në Tregun e telekomunikimeve të Kosovës me ofrim të rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike.

Numri i Punëtorëve

Me datën 1 Janar 2017 numri i përgjithshëm i të punësuarve në KOSTT ka qenë 360. Gjatë vitit janë pensionuar 12 punëtorë, kanë vdekur 2, u është ndërprerë puna 2 punëtorëve dhe janë pranuar 3 punëtorë të rinj.

Këto lëvizje kanë sjell numrin e përgjithshëm të punëtorëve më 31 dhjetor 2017, në **347** punëtorë.

Në vazhdim është dhënë Organo gram – Makro Struktura organizative e KOSTT-it.



	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 85 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

3.2. Përmbledhja dhe përshkrimi i procedurave gjyqësore

Nr.R	Lënda Nr. Gjykata Kompetente	Paditës	I paditur	Objekti i Kontestit	Vlera e Kontestit
1	P.nr.326/0 Gjykata Themelore Kaçanik	KOSTT	Nebih Bela, Veli Bela dhe Minir Mani	Vjedhje	2,370.00 €
2	P.nr. 2406/ 06 Gjykata Themelore Prishtinë	KOSTT	Ivica Filipoviq dhe Millorad Iliq	Vjedhje	15,398.00 €
3	P.nr. 284/06 Gjykata Themelore Prishtinë	KOSTT	Avdullah Bejtullahu dhe Afrim Bejtullahu	Vjedhje e rëndë	Nuk është përcaktuar
4	C.nr. 409/06 Gjykata Themelore Prishtinë	Hajrije dhe Milazim Zeka	KOSTT	Lirimi i banesës	Nuk është përcaktuar
5	C.nr. 2168/04 Gjykata Themelore Prishtinë	KOSTT	Kadri Rukovci	Lirimi i banesës	Nuk është përcaktuar
6	C.nr.571/11 - C.nr.351/15 Gjykata Themelore Skenderaj	Shaqir Duli	KOSTT	Kompensim Dëmi	10,000.00 €
7	C.nr. 156/09 Gjykata Themelore Prishtinë	Selvije Dedinca etj	KOSTT	Pagesa e rentës	600 € Pagesë Mujore
8	C.nr. 270/07 C.nr.202/14 Gjykata Themelore Podujevë	Mustafë Hasani etj	KOSTT	Kompensim Dëmi	1,242,910.00 €
9	C.nr.218/11 Gjykata Themelore Ferizaj	Fevzi Nebihu	KOSTT	Pengesë Posedimi	1,600.00 €
10	E.nr.281/06 Gjykata Themelore Lipjan	KOSTT	Momqillo Mitiq	Kompensim dëmi	2,176.50 €
11	C.nr.244/2013 Gjykata Themelore Prishtinë	KOSTT	KEK	Kompensim dëmi	140,285.56 €
12	C.nr.438/10 Gjykata Themelore Ferizaj	Kenan Mehmeti	KOSTT	Pagesa e rentës	29,764.49 €
13	Nd.nr. 42/09 Gjykata Themelore Ferizaj	Agron Vuçitërna	KOSTT/ KEK	Kompensim dëmi	Nuk është përcaktuar
14	C.nr.116/13 Gjykata Themelore Gjilan	Xhevat Qerimi	KOSTT/ KEK	Të drejtën e blerjes banesore	Nuk është përcaktuar
15	C.nr.58/14 Gjykata Themelore Pejë	Hetema Cikotiq	KOSTT	Të drejtën e blerjes banesore	Nuk është përcaktuar
16	C.nr.127/14 Gjykata Themelore Pejë	Hamdija Cikotiq	KOSTT	Të drejtën e blerjes banesore	Nuk është përcaktuar
17	A.nr. Gjykata Themelore Prishtinë	KOSTT	OSHP	Propozim për masën e përkohshme	Nuk është përcaktuar

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 86 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

18	C.nr.106/14 Gjykata Themelore Vushtri	Bejtullah Isufi dhe Nazif Isufi	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	2,002.00 €
19	C.nr.142/14 Gjykata Themelore Vushtri	Aziz Klinaku	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	14,226.00 €
20	C.nr.172/14 Gjykata Themelore Lipjan	Sali Shala dhe Avdullah Shanhini	KOSTT	Kompensim dëmi	4,000.00 €
21	C.nr.327/14 Gjykata Themelore Prishtinë	Selviqe Dedinca etj	KOSTT	Kompensim i Kamatës	600.00 €
22	C.nr.45/14 Gjykata Themelore Drenas	Bajram Hisen Hajradini	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	5,904.00 €
23	C.nr.48/14 Gjykata Themelore Drenas	Gani dhe Afrim Morina	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	Nuk është përcaktuar
24	C.nr.139/04 Gjykata Themelore Podujevë	Nebi Sadiku etj	KOSTT/KEK	Kompensim dëmi LP400kV	732,000.00 €
25	C.nr.32/14 Gjykata Themelore Drenas	Ahmet Fazlija	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	23,503.50 €
26	C.nr. 47/14 – 3/15 Gjykata Themelore Drenas	Shaqir Podrimqaku	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	34,421.90 €
27	C.nr.49/14 – 51/14 Gjykata Themelore Drenas	Shaqir Nysret Binaku	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	28,568.60 €
28	C.nr.1/15 Gjykata Themelore Drenas	Ismet Binaku	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	Nuk është përcaktuar
29	C.nr.42/15 Gjykata Themelore Drenas	Ejup Hoxha	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	1,073.00 €
30	C.nr.5/15 Gjykata Themelore Drenas	Dibran Morina	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	5,120.73 €
31	C.nr.43/14 Gjykata Themelore Drenas	Hetem Binaku	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	46,665.40 €
32	C.nr.6/15 Gjykata Themelore Drenas	Sabit Morina	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	13,478.50 €
33	C.nr.44/14 Gjykata Themelore Drenas	Feriz Bytyqi	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	1,075.00 €
34	C.nr.46/15 Gjykata Themelore Drenas	Lulzim Makolli	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	2,842.25 €
35	C.nr.27/15 Gjykata Themelore Drenas	Asmon Binaku	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	41,648.60 €
36	C.nr.34/15 Gjykata Themelore Drenas	Jakup Krasniqi etj	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	4,868.00 €
37	C.nr.33/15 Gjykata Themelore Drenas	Agim Hoxha	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	6,114.00 €
38	C.nr.40/15 Gjykata Themelore Drenas	Nazif Krasniqi	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	9,567.36 €

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 87 nga 96</i>

Departamenti Financiar

Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:

39	C.nr.39/15 Gjykata Themelore Drenas	Qamil Hoxha	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	7,702.20 €
40	C.nr.41/15 Gjykata Themelore Drenas	Shukrije Bytyqi	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	23,488.10 €
41	C.nr.46/15 Gjykata Themelore Drenas	Rifat Krasniqi	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	9,651.60 €
42	C.nr.44/15 Gjykata Themelore Drenas	Bajrush Karaqica	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	40,769.00 €
43	C.nr.347/14 Gj.Th..Prishtin	KOSTT	N.T.SH-PPC-IT	Zhdëmtim	314,312.99 €
44	C.nr.791/15 Gjykata Themelore Prishtinë	Nazmi Shaljani	KOSTT	Dislokim Shtylle ose sig. parc e re	81,818.00 €
45	C.nr.1642/19 Gjykata Themelore Prishtinë	Ilmi Jakupi	KOSTT	Dëmshpërblim	Nuk është përcaktuar
46	C.nr.987/14 Gjykata Themelore Pejë	Hamdi Sadriaj	KOSTT/KEDS	Dëmshpërblim	20,000.00 €
47	C.nr.56/13 Gjykata Themelore Graçanicë	Ramadan dhe Veton Selimi	KOSTT	Dëmshpërblim	3,663.00 €
48	C.nr.115/13 Gjykata Themelore Gjilan	Njazi Spahiu	KOSTT	Dislokim Shtylle dhe komp. Dëmi	
49	C.nr.162/15 Gjykata Themelore Vushtrri	Velimir Terentiq	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	6,830.00 €
50	C.nr.2131/12 Gjykata Themelore Prishtinë	Sahit Vitija	KOSTT	Kompensim dëmi	Nuk është përcaktuar
51	C.nr.8/16 Gjykata themelore Drenas	Asllan Krasniqi	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	29,293.50 €
52	C.nr. 11/2015 Gjykata Themelore Rahovec	Feriz Vehapi	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	14,870.00 €
53	C.nr.12/15 Gjykata Themelore Rahovec	Ejup Sopjani	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	Nuk është përcaktuar
54	C.nr.269/15 Gjykata Themelore Gjakovë	Shemsedin Dervishaj	KOSTT	Kompensim dëmi LP400kV	Nuk është përcaktuar
55	A.nr. Gjykata Themelore Prishtinë – Departamenti Administrativ – Divizioni Fiskal	KOSTT	ATK	Anulim Vendimi	Nuk është përcaktuar
56	C.nr. Gjykata Themelore Pejë	KOSTT	KK Pejë - AKP	Privatizimi	Nuk është përcaktuar
57	C.nr.52/14 Gjykata Themelore Kaçanik	Ismajl Luzha	KOSTT	kompensim dëmi	Nuk është përcaktuar
58	C.nr.52/14 Gjykata Themelore Gjilan	Isen Isuifi	KOSTT	vertetim pronësie	Nuk është përcaktuar
59	C.nr.13/10 Gjykata Themelore Gjilan	KEK	Bozha Viqentievij	E drejta banesore	Nuk është përcaktuar
60	C.nr.291/16 Gjykata Themelore Rahovec	Veli Lezi	KOSTT	Masa drusore	469.14 €
61	C.nr.211/16 Gjykata Themelore Pejë	Idriz dhe Burim Tahiri	KOSTT	Kundershëm te shumës se kompensimit	Nuk është përcaktuar
62	C.nr.218/16 Gjykata Themelore Pejë	Sali Ahmeti	KOSTT	Kundershëm te shumës se kompensimit	Nuk është përcaktuar

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 88 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

63	C.nr.213/16 Gjykata Themelore Pejë	Mejreme Kurtaj	KOSTT	Kundershtim te shumes se kompensimit	Nuk është përcaktuar
64	C.nr.212/16 Gjykata Themelore Pejë	Hira Ahmeti	KOSTT	Kundershtim te shumes se kompensimit	Nuk është përcaktuar
65	P.nr 31/15 C.nr 43/17 Gjykata Themelore Istog	Prokuroria KOSTT	Haxhi Mujaj	Vjedhje	1,437.00 €
66	C.nr.29/15 Gjykata Themelore Istog	Xhevdet Berisha	KOSTT	Kundershtim te shumes se kompensimit	8,000.00 €
67	C.nr.175/15 Gjykata Themelore Gjakovë	Sali Zeqiri	KOSTT	Kundershtim te shumes se kompensimit	Nuk është përcaktuar
68	C.nr 8/15 C.nr 8/16 Gjykata Themelore Gjakov	Skender Dervishaj	KOSTT	Kundershtim te shumes se kompensimit	Nuk është përcaktuar
69	C.nr 171/15 Gjykata Themelore Prishtinë	Fadil Ismajli	KOSTT	Kundershtim te shumes se kompensimit	Nuk është përcaktuar
70	C.nr 1400/13 Gjykata Themelore Prishtinë	Iliaz Rama	KOSTT	kompensim dëmi	4,800.00 €
71	C.nr 394/17 Gjykata Themelore Prishtinë	KOSTT	PRISIG KS	kompensim dëmi	3,500.00 €
72	C.nr. 188/17 Gjykata Themelore Gjakove	Sali Idrizi	KOSTT	Kundershtim te shumes se kompensimit lidhur me ndërtimin e linjës 400kV Kosovë-Shqiperi	
73	EK 564/2015 Gjykata Themelore Prishtinë	“Solid” shpk	KOSTT		
74		KOSTT	Kamer Aliu, etj..	Lirim objekti	
75		KOSTT	Inspektorati i Punes	Për Anulim të Vendimit	

Totali i vlerës KOSTT si i paditur:: 2,513,307.87 €

Totali i vlerës KOSTT si paditës: 479,480.05 €

Sqarim: *Vlerat për kontestet gjyqësore janë të bazuara sipas zhvillimeve në procedurat gjyqësore dhe mund të ndryshojnë me zhvillimin e mëtutjeshëm të procedurave.*

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 89 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

3.3. Kontratat/Transaksionet e konsiderueshme gjatë vitit 2017 nga burimet e KOSTT

<u>Nr.</u>	<u>Departamenti</u>	<u>Lloji i Prokurimit</u>	<u>Nr. i Procedurës</u>	<u>Emri I Projektit</u>	<u>Kontraktoret</u>	<u>Vlera e Kontratës</u>	<u>Vlera e Realizuar e Kontratës</u>	<u>Vlera e mbetur për realizim</u>	<u>Përqindja e Realizimit</u>	<u>Nr. i Protokollit</u>
1	Departamenti i Operatorit të Sistemit	Punë	48	Mirembajtja e Sistemit SCADA/EMS	GRID SOLUTION SAS	270,000.00 €	0.00 €	270,000.00 €	0.00%	nr.97 dt.18.12.2017
2	Departamenti i Burimeve Njerëzore	Shërbime	36	Mirëmbajtja e CAS-it dhe modifikimet e mundshme	KOMTEL PE	179,773.00 €	16,933.00 €	162,840.00 €	9.42%	nr.70 dt.15.08.2017
3	Departamenti i Operatorit të Transmisionit	Furnizim	003-2016	Furnizim me pajisje për trajtimin e vajit izolues	Rima - engineering	142,588.40 €	135,629.18 €	6,959.22 €	95.12%	nr.276 dt.18.01.2017
4	Departamenti i Operatorit të Transmisionit	Furnizim	4	Furnizimi me ndërprerës 400kV	G3 Engineering	142,500.00 €	142,500.00 €	0.00 €	100.00%	nr.57 dt.30.06.2017
5	Departamenti i Burimeve Njerëzore	Punë	18	Renovimi i lokalit në Kurriz	ASTRAPLAN	94,856.71 €	72,187.59 €	22,669.12 €	76.10%	nr.61 dt.20.07.2017



RAPORT VJETOR

DT-FI-008

ver. 1.1

faqe 90 nga 96

Departamenti Financiar

Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:

6	Departamenti i Operatorit të Transmisionit	Shërbime	29	Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve tip:VW	BAKI AUTOMO BILE	90,000.00 €	16,453.33 €	73,546.67 €	18.28%	nr.71 dt.22.08.2017
7	Departamenti i Burimeve Njerëzore	Furnizim	17	Furnizim me harduer	KOMTEL PE	86,206.50 €	82,142.47 €	4,064.03 €	95.29%	nr.49 dt.07.06.2017
8	Departamenti i Burimeve Njerëzore	Furnizim	044/2016	Furnizimi me material higjienik	konz: Global Parajsa & Edukimi	84,649.66 €	16,042.33 €	68,607.33 €	18.95%	nr.14 dt.22.02.2017
9	Departamenti i Operatorit të Transmisionit	Shërbime	30	Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve tip:Toyota	BENI	78,000.00 €	5,824.95 €	72,175.05 €	7.47%	nr.68 dt.09.08.2017
10	Departamenti i Operatorit të Transmisionit	Shërbime	31	Mirëmbajtja dhe Servisimi i Automjeteve, tipi : LANDROVER NISSAN dhe FORD	LTG kosova	72,000.00 €	2,468.36 €	69,531.64 €	3.43%	nr.90 dt.27.10.2017
Vlerat totale :						1,240,574.27 €	490,181.21 €	750,393.06 €	39.51%	

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 91 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

Vlera TOP 10 kontratave të kontraktuara përgjatë vitit 2017 është : 1,240,574.27 € me përqindje të realizimit : 39.51%

Përqindja e realizimit në vlerën 39.51% paraqet përqindjen vetëm për TOP 10 projektet më të mëdha sipas LPP përgjatë vitit fiskal 2017

* Në vitin 2017 janë kontraktuar **66 kontrata (mbi vlerën 1000.00€)**, saktësisht :

- **59 kontrata** me procedurë të hapur
- **7 kontrata** me Procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontrate

***Vlera e të gjitha kontratave të kontraktuara është : 2,353,651.95 € , me përqindje të realizimit : 46.97%**

***Inicimi i aktiviteteve të prokurimit:**

Të gjitha kërkesat për inicim të aktiviteteve të prokurimit kanë filluar me kohë, pas pranimit të zotimit të mjeteve(deklaratës së disponueshmërisë së mjeteve financiare) dhe specifikimeve të kompletuara teknike në gjuhët shqipe, angleze dhe serbe.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 92 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

2.4. Sugjerime dhe propozime për rritjen e performancës

Në mënyrë që KOSTT të rritë edhe më tutje performancën, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet:

- Vazhdimin të ngritjes së efijencës në mirëmbajtjen dhe operimin e sistemit të transmetimit
- Implementimit të projekteve kryesore që risin kapacitetet e operimit dhe arritjen e efijencës të të hyrave nga investimet;
- Përmirësimet në asetet e transferuara nga KEK-u dhe futja e teknologjisë për monitorim, kontroll, matje dhe operim, pajisja e të gjitha objekteve (NS-ve)
- Përgatitjet për implementimin e plotë të Rregullave të Tregut
- Vazhdimi i trajnimit të stafit dhe formave tjera të zhvillimit për përcjellje të ndryshimeve teknologjike që ritë shkathtësitë dhe njohuritë për ngritjen e efijencës në KOSTT;
- Vazhdimi i shqyrtimit të masave motivuese për stafin për ngritjen e kualitetit të punës së tyre.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 93 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

Lista e shkurtesave

AATC - (Average Available Transfer Capacity) - Kapaciteti i Disponueshëm Mesatar (Import/Eksport)

AC-DC – Shpenzimet vetanake

AIT – (Average interruption time) - koha mesatare e rënieve

ATC – (Available Transfer Capacity) – Kapaciteti i disponueshëm

BCU- (Bay Controll Unit)- njësia kontrolluese

BERZH – Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

BD – Bordi i Drejtorëve

BK – Buxheti i Kosovës

BNJ – Burimet Njerëzore

CACM – (Capacity Allocation and Congestion Management) – Menaxhimi i Alokimit të Kapaciteteve dhe Kongestionit

CAO – (capacity Allocation Office) – Zyra e Alokimit të Kapaciteteve

CGES- (crnogorski Elektro Sistem) – OST i Malit të Zi

CM – (Congestion Management)- Menaxhimi i kongestionëve

DMS-(Documents Management System) – Sistemi për menaxhimin e dokumentacionit

EJL – Evropa Juglindore

EMS- (Elektro Mreza Srbije) - Rrjeti Elektrik i Serbisë

ENS- (Energy not supplied)-Energjia e pa furnizuar

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 94 nga 96</i>
<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>		

ENTSO E - (European Network of Transmission System Operators for Electricity)- Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike

FAC- (Final Acceptance Certificate) – Çertifikata e pranimit final

GSM –(Global System for Mobile Communication) – sistemi i përgjithshëm i komunikimit mobil

GJK – Gjykata Komunale

GjQ – Gjykata e Qarkut

HC - Hydrocentral

HMI – (Human Machine Interface) – ndërlidhja makinë-njeri

HVM- (High Voltage Metering) – matësi i energjisë

IKP – Indikatorët Kyç të Performancës

IPA- Instrumentet para anmtarësimit në Bashkimin Evropian

ITC – Inter TSO Compensation (Kompensimi mes Operatorëve të Sistemit të Transmetimit)

KA – Konflikt Administrativ

KAEF – (Kosovar American Education Fund) – Fondi Kosovar Amerikan për Arësim

KEK – Korporata Energjetike e Kosovës

KESCO - (Kosovo Electricity Supply Company)- Kompania e Kosovës për Furnizim me Energji Elektrike

KfW- Banka Gjermane për Zhvillim

KIEK – Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

KOSTT- Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu

KQKO - Komiteti për Qeversje të Kodeve Teknike/Operacionale

LP – Largpërçuesi

LPP – Ligji i Prokurimit Publik

MATC - Kapaciteti i Disponueshëm Maksimal (Import/Eksport)

MeM- Memorandumi i Mirëkuptimit

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 95 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>

MEPSO (Makedonski Elektroprenosen Sistem Operator) – Ooeratori i sistemit dhe transmetimit të Maqedonisë

MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planit Hapsionor

MPI – Menaxhimi i Projekteve dhe Inxhinieria

MSA – Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit

MZHE – Ministria e Zhvillimit Ekonomik

NEF (Net Export Flow) – Eksporti i Kosovës

NIF - (Net Import Flow) – Importi neto për nevojat e Kosovës

NMS – (Network Management System) – Sistemi për menaxhimin e rrjetit

NS - Nënstacioni

NP – Ndërmarrjet publike

NJPMNP – Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike

OPGW – fibri optik

OS – Operatori i Sistemit

OST – Operator i Sistemit të Transmetimit

OT – Operatori i Transmetimit

PpE - Propozim për Ekzekutim

PZhT – Plani Zhvillimor i Transmetimit

RSC – (Regional Security Coordination) – Koordinimi i Sigurisë Rajonale

SCADA /EMS- (System Control and Data Acquisition/Energy Management System)
-Sistemi i kontrollit dhe grumbullimit të të dhënave/Sistemi i manaxhimit të energjisë

SECI (South –East Europe Cooperative Initiative)- Iniciativa e Evropës Jug-Lindore për Bashkëpunim

SKE – Sekretariati i Komitetit të Energjisë

SMT – Sistemi për Menaxhimin e Tregut

SEE – Sistemi Elektro Energjetik

TC A – Termocentrali Kosova A

	RAPORT VJETOR	DT-FI-008
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 96 nga 96</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori i Buxhetit dhe Planifikimi Strategjik:</i>	

TC B – Termocentrali Kosova B

TCP/IP – (Transport Communication Protocol) – Internet protokole të komunikimit

TE- (Transmitted energy)- Energjia e transmetuar

TI – Teknologjia e informacionit

TMR – Transformatori matës i rrymës

TL – Tensioni i lartë

ToR (Terms of Reference) – Termat e Referencave

TTC – (Total Transfer Capacity) – kapaciteti total i bartjes

USAID - (United States Agency for International Development) – Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

ZRRë – Zyra e Rregullatorit të Energjisë